REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 40 pika h) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon Kuvendit të Komunës që :

Në mbështetje të neneve 12 par. 12.2, pika c) dhe 17, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit nr. 03/l-025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neneve 9 dhe 20 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës së Lipjanit në mbledhjen e datës ________________, miratoi këtë:

**PROPOZIM**

VENDIM
PËR MIRATIMIN E PLANIT LOKAL TË VEPRIMIT NË MJEDIS
2023 -2027

**Neni 1**

**MIRATOHET**, Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2023-2027 i Komunës së Lipjanit.

**Neni 2**

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2023-2027.

**Neni 3**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në bashkëpunim me drejtoratet përkatëse komunale

**Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë publikimit në faqen elektronike të Komunës .

## Arsyetim

Baza juridike për ta miratuar këtë Propozim-Vendim është e përcaktuar me dispozitat e të neneve 12, par. 12.2, pika c) dhe 17, të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 24 të Ligjit nr. 03/l-025 për Mbrojtjen e Mjedisit si dhe neneve 9 dhe 20 dhe të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Draft -Plani Lokal i Veprimit në Mjedis 2023-2027 i Komunës së Lipjanit ka qenë në konsultim me publikun konform dispozitave të legjislacionit në fuqi .

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.

1Nr. 352/01-65468
Lipjan, më 09.12.2022

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E LIPJANIT LIPJAN OPŠTINA LIPLJAN REPUBLIKA KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**PROPOZIM**

# PLANI LOKAL I VEPRIMIT NË MJEDIS
# 2023 -2027

*"Për komunën tonë"*



**LIPJAN 2022**

**Përmbajtja:**

Fjala e Kryetarit të Komunës.
Akterët dhe subjektet përgjegjëse për hartimin e PLVM-së.

**I.HYRJE**
1. Hyrje
2. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së
3. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së
4. Procesi dhe metodologjia për përgatitjen e PLVM-së

**II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME – PROFILI I KOMUNËS**
1. Pozita gjeografike
2. Kushtet klimatike
3. Pedologjia dhe gjeologjia
4. Infrastruktura teknike
5. Infrastruktura sociale
6. Trashegimia kulturore

**III.PRESIONET NE MJEDIS**
1. Popullsia dhe vendbanimet
2. Industria dhe bizneset
2.1. Sektori minerar
3. Transporti
4. Bujqesia

**IV. GJENDJA E MJEDISIT**
1. Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre
2. Ajri dhe zhurma
3. Toka dhe ndotja e saj
3. Menaxhimi i mbeturinave
5. Natyra dhe biodiversiteti

**PROBLEMET DHE PRIORITETET MJEDISORE**
1. Problement mjedisore
2. Prioritetet
3. Plani i aktiviteteve
4. Plani i monitorimit për zbatimin e PLVM-së

**Fjala e Kryetarit të Komunës**

Në kuadër të ruajtjes së vlerave themelore dhe bartajes së tyre në brezat e ardhshëm, është e domosdoshme edhe mbrojtja e mjedisit, si një nga vlerat më të rëndësishme.

Mbrojtja e mjedisit është shqetësim serioz në nivel global. Këtë shqetësim e kemi edhe ne, sidomos tani pasi që vendi ka kaluar periudhen e përmbushjes së nevojave ekzistenciale me të cilat jemi përballur nga viti 1999.

Ruajtja e mjedisit është përgjegjësi e niveleve të ndryshme të shoqërisë, duke filluar nga individi, komuniteti lokal dhe shoqëria në tërësi. Prandaj është momenti i fundit për të vepruar në trajtimin dhe zgjidhjen e problemeve mjedisore.

Komuna e Lipjanit ka hartuar dhe prezanton Planin Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM) për periudhen 2023-2027. Ky Plan është dokument themelor strategjik për të vepruar në zgjidhjen e problemeve të identifikuara mjedisore në nivelin lokal.

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis bashkon interesat e komuniteteve, vlerat dhe perspektivat e ndryshme në kuadër të një plani për zhvillim të qëndrueshëm, i cili përveç vlerave të tjera, duhet gjithashtu të njohë dhe të identifikoj edhe problemet mjedisore.

Qëllimi i PLVM-së është të krijojë politika të përbashkëta të mbrojtjes së mjedisit në kontekst të zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm të Komunes së Lipjanit.

Prioritetet themelore mjedisore për Komunën e Lipjanit mbi të gjitha përfshijnë: përmirësimin e sistemit për grumbullimin e mbeturinave, eliminimin e deponive ilegale të mbeturinave, rritjen e nivelit dhe mundësive për ndarjen dhe riciklimin e mbeturinave, resurset ujore dhe menaxhimin e tyre, mbrojtjen e cilësisë së ujërave sipërfaqësore, rritjen e cilësisë dhe sasisë së ujit të pijes, mbrojtjen nga vërshimet dhe përmbytjet, ruajtjen e pyjeve nga prerja pa kriter dhe djegia, plotësimin e bazës rregullative, programore dhe institucionale për menaxhimin e ndotjes së ajrit, përmirësimin e cilësisë së ajrit, reduktimin e zhurmës, mbrojtjen e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimi, erozioni dhe përmirësimi i tokave të degraduara, ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte, rritjen e numrit të zonave të mbrojtura dhe promovimi i vlerave të tyre natyrore, parandalimi i veprimeve që e dëmtojën natyrën, biodiversitetit dhe pyjet si dhe njohja e rëndësisë së biodiversiteti dhe vlerave të tij.

Duke hartuar politika efikase për mbrojtjen e natyrës, duke i rritur sipërfaqet e zonave të mbrojtura, duke mbrojtur llojet e rralla bimore e shtazore dhe duke mbrojtur pyjet, si dhe duke zbatuar veprimet e përcaktuara, do të krijojmë kushte për jetë më të shëndetshme në kohën e tanishme dhe për të ardhmen.

Në emër të Komunës së Lipjanit dhe qytetarëve, falënderoj të gjithë kontribuesit në hartimin e PLVM 2023 – 2027, Grupin punues, si dhe të gjithë akterët tjerë pjesëmarrës. Njëkohësisht ftoj institucionet përkatëse dhe të gjithë qytetarët që këtë dokument strategjik mjedisor ta përvetësojmë si një vlerë të përbashkët, i cili do të ndikoj në rritjen e cilësisë së jetës për të gjithë.

Përzemërsisht,

Imri AHMETI
Kryetar i Komunës së Lipjanit

**Akterët dhe subjektet përgjegjëse për hartimin e PLVM-së**

Grupi Punues për hartimin e PLVM është themeluar nga Kryetari i Komunës me Vendimin 01Nr.020/04-16928 të datës 31.03.2022 në përbërje prej:

1. Imri Semetishti, Drejtor i DPUMM- Kryesues;
2. Avni Sahiti, Drejtorati për Inspektorat – anëtar;
3. Islam Kaleshi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore – anëtar;
4. Hanushe Berisha, DPUMM- anëtare;
5. Labinot Dedushi, Drejtorati për Infrastrukturë – anëtar;
6. Imri Bytyçi, KRM "Pastrimi" Lipjan - anëtar;
7. Bekim Krasniqi, OJQ- YAHR, Lipjan - anëtar;
8. Milazim Miftari, Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – anëtar;
9. Selman Jashanica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport - anëtar; dhe
10. Hasan Hajdini, Drejtorati për Shërbime Publike, Mbrojtje dhe Shpëtim – anëtar.

## KREU I. HYRJE

### 1. Hyrje

Planet Lokale të Veprimit në Mjedis (PLVM) janë dokumente strategjike mjedisore vendore, të cilat paraqesin prioritete mjedisore dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtyre planeve zhvillon më tej aftësitë e pushtetit lokal dhe subjekteve të tjera të interesuara për mjedisin dhe komunitetin.

PLVM është pikë fillestare për zhvillimin e një komuniteti të qëndrueshëm ashtu që të ndihmojnë komunitetin për të ekzaminuar dhe adresuar në mënyrë adekuate çështjet kryesore mjedisore që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe në shëndetin e ekosistemeve.

PLVM përfshin zhvillimin e vizionit të komunitetit, vlerësimin e çështjeve mjedisore, përcaktimin e prioriteteve, identifikimin e strategjive më të përshtatshme për adresimin e problemeve kryesore dhe zbatimin e veprimeve me qëllim të arritjes së përmirësimeve reale mjedisore dhe shëndetësore.

Gjithashtu, PLVM nxitë bashkëpunimin midis shoqërisë civile, publikut, pushtetit lokal dhe atij qendror, biznesit dhe subjekteve të tjera mjedisore, duke përkrahur shkëmbimin e lirë të informacioneve dhe pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

### 2. Baza ligjore për hartimin e PLVM-së

Legjislacioni i Republikës së Kosovës në fushën e mbrojtjes së mjedisit i përafruar me standardet evropiane. Hartimi i PLVM nga qeverisjet vendore është detyrë ligjore e përcaktuar me nenin 24 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit. Përveç Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, në përgatitjen e PLVM është marrë parasysh edhe:

Ligji për Mbeturinat Nr. 04/L-60;
Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 03/L-160;
Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr. 03/L-233;
Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;

Ligji për Planifikim Hapësinorë Nr.04/L-174;
Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;
Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr. 03/L-214;
Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura Nr. 03/L-039;
Ligji për Vlerësimin Strategjik Mjedisor Nr. 03/L-230;
Udhëzimet përkatëse Administrative;
Strategjia e Kosovës për Mjedisin (SMM) (2013 - 2022);
Plani Zhvillimor i Komunes se Lipjanit 2013-2023.

## 3. Qëllimi dhe objektivat e PLVM-së

Qëllimet e PLVM rezultojnë në:

a) Zgjidhjen e problemeve mjedisore nëpërmjet identifikimit të prioriteteve dhe përcaktimit të veprimeve për zgjidhjen e tyre, duke përfshirë të gjithë akterët e mundshëm për përcaktimin e këtyre veprimeve sipas një Plani të Veprimit.

b) Zhvillimin e shoqërisë civile nëpërmjet forcimit të koordinimit dhe komunikimit ndërmjet sektorëve të ndryshëm në komunitet, që përfaqësojnë interesa të ndryshme përfshirë autoritetet vendore, përfaqësues të OJQ-ve, biznesin dhe komunitetin.

c) Rritjen e aftësisë së qeverisjes lokale dhe komunitetit për paraqitjen e elementëve thelbësore të planit të veprimit të komunitetit, duke vlerësuar problemet dhe mundësitë komunitare, duke organizuar komitete qytetare, duke përfshirë publikun, përcaktimin e prioriteteve, hartimin e strategjive dhe zhvillimin e një Plani të Veprimit.

d) Rritjen e shkëmbimit të informacioneve në nivel lokal nëpërmjet sjelljes së shembujve dhe modeleve nga plane të mëparshëm të komuniteteve nga të cilat pjesëmarrësit mund të nxjerrin ide dhe teknika të zbatueshme në rastet konkrete të tyre, të mbledhin me kujdes informacion mbi gjendjen e tanishme të mjedisit.

e) Ofrimin e zgjidhjes konkrete për problemet e komunitetit me anë të shkëmbimit të përvojave lidhur me përdorimin e aftësive në analiza, planifikime, debate dhe vlerësime që janë thelbësore për një veprim të komunitetit efektiv duke u dhënë pjesëmarrësve mundësinë për të vënë në praktikë punën në grupe, duke u marrë me zgjidhjen e problemeve praktike nëpërmjet ndërveprimit të grupeve të vogla të punës.

**PLVM për Komunën e Lipjanit, si objektiva ka:**

a) Zbutjen e degradimit mjedisor duke lidhur në mënyrë efektive proceset kryesore të planifikimit të zhvillimit në komunë.

b) Pozicionimin e komunës si aktor themelor për identifikimin dhe bashkëpunimin me burimet e mundshme qendrore dhe lokale të financimit për projektet prioritare komunale.

c) Përmirësimin e kushteve të jetesës duke siguruar mbështetje financiare për projektet prioritare komunale.

d) Transparencen për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.

e) Integrimin e metodës së qasjes me bazë gjinore për të identifikuar dhe vendosur prioritetet mjedisore në komunitetet lokale; dhe

f) Krijimin e kapaciteteve të forta për të zhvilluar dhe zbatuar PLVM-n dhe për identifikimin dhe shfrytëzimin e opsioneve të financimit.

### 4. Procesi dhe metodologjia e përgatitjes së PLVM-së

Plani Lokal i Veprimit në Mjedis për Komunën e Lipjanit u hartua përgjatë disa muajve dhe në hartimin e tij, janë përfshirë profesionist të pushtetit vendor dhe komuniteti i gjerë. Për këtë u ngrit një grup pune me njohuri profesionale të fushave të ndryshme (ambientalizëm, arkitekturë, turizëm, shëndetësi, arsim, sport, trashëgimi kulturore, etj.), të cilët punuan në bashkëpunim me ekspertë të tjerë nga vendi për hartimin e PLVM.

Në kuadër të projekti për hartimin e Planit Lokal për Veprim në Mjedis (PLVM), është bërë një anketim i qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ka qenë një numër i konsiderueshëm i pyetësorëve, të cilët kanë ndihmuar dhe orientuar grupin punues në mënyrë më të drejtë në zgjedhjen e fushave prioritare. Një falënderim për këtë i takon qytetarëve të Komunës së Lipjanit dhe shoqërisë civile, e cila në procesin e anketimit të respondentëve ka ndihmuar që procesi i anketimit të jetë i suksesshëm.

Për të pasur një përfshirje sa më të gjerë dhe për të marrë mendimet e komunitetit dhe shoqërisë civile, janë organizuar edhe debate publike dhe debate në media.

Dokumenti është i hartuar në tri shtylla themelore:

1. Analiza e gjendjes mjedisore
Paraqet një analizim të hollësishëm të situatës për të gjitha çështjet e marra në konsideratë nga plani, duke e paraqitur atë në të gjitha aspektet e tij dhe të ndërlidhura ndërmjet tyre. Kjo analizë shërben për të pasur një ide më të qartë të problemeve mjedisore, të cilat shqetësojnë Komunën e Lipjanit.

2. Lista e problemeve mjedisore
Problemet mjedisore paraqiten sipas një matrice të paracaktuar, e cila jep në mënyrë të detajuar të gjithë treguesit për identifikimin e një problemi. Pjesët më të rëndësishme të kësaj matrice janë shkaktarët e problemit dhe përcaktimi i prioritetit për secilin prej tyre.

3. Plani i veprimeve për zgjidhje
Ky kapitull është pjesa më e rëndësishme e Planit, pasi paraqet të gjitha veprimet dhe projektet e mundshme për zgjidhjen e problemeve mjedisore të përcaktuara.
Kjo matricë u shërben autoriteteve kompetente për të hartuar projektet konkrete dhe për sigurimin e fondeve nga donatorët.

## II. INFORMATAT E PËRGJITHSHME - PROFILI I KOMUNËS

### 1. Historiku dhe Pozita gjeografike

Si vendbanim Lipjani njihet që nga koha Ilire e mê vonë Romake si pjesë e qytetit Ulpiana, e Cila ndodhet në verilindje, në largësi 10km. Lipjani në periudhën romake, ishte kryesisht një vendbanim i vogêl ne rrugën për ne Lissum. Identifikimi i Lipjanit me emrin. „Ulpiana" më vonë, është vërtetuar edhe me zbulimet e gërmadhave tê antikës së vjetêr, tê periudhës bizantine.

Nga antika e vjetër ernri Lypenion, Lypiana, padyshim vijnë deri te emri i tashëm Lipjan. Nën themelet e kishës ekzistuese, në këtë pjesê, janë zbuluar themelet e bazilikës bizantine, ndërsa nga

vet Lipjani janë tê njohura disa monumente-epigrafe, prej tê cilave vërtetohen tê dhënat per ekzistimin e Ulpianës.

Me zhvillimin e industrisë-minierës nê vendbanimin e Janjevês, u bê e njohur edhe Prishtina, kështu që Lipjani, humbi rëndësinë e mëparshme dhe funksiononte si një "shesh" i thjeshtë lokal.

Janjeva per herë tê parë është përmendur në vitin 1303, me zhvillimin e industrisë sê minierave në shekz XIV dhe XV, u ngrit nê një qendër tê rëndësishme afër Prishtinës dhe Novobërdës (Artanës). Në mes tjerash, qyteti kishte kontakte me Republikën e Raguzës (Dubrovniku) i sotëm në Kroaci.

Njëra nga shkollat e para ne Kosovë, është hapur në Janjevê në vitin 1665 dhe përdoret edhe sot e kësaj dite.

Në përgjithësi, deri me ndërtimin e hekurudhês në fund tê shekullit të XIX (1873-1874), Lipjani ishte një fshat i rëndomtë, i njohur si kryqëzim i rrugëve në rajon. Në këtë hekurudhë, Lipjani fitoi stacionin hekurudhor, krahas tê cilit u ndërtuan punëtoritê e para me karakter tregtar, depot per grumbullimin e drithërave dhe dyqane zejtare, kështu deri në fund te shek. XIX, gjatë kohës së sundimit turk, kjo pjese e re e Lipjanit fitoi pamjen me karakter qyteze, kurse si qytezë është shpallur ne vitin 1920.

Me funksionimin e hekurudhës Kosovë-Maqedoni, qarkullimi kryesisht ishte përmes Greqisë (qyteti i Selanikut- ish Solun), kështu konkurrenca e tregut dhe aktivitetet tregtare, ndikuan në qendrat si: Mitrovica, Ferizaj dhe Lipjan, në dobësimin e tregut në qendrat më të mëdha si Prishtina, Gjakova dhe Prizreni. Qê nga kjo kohë fillon tê zhvillohet Lipjani. Nga kjo rrjedh se ndikimi i Lipjanit më shumê shtrihet në rrethinën rnë tê afërt si në pjesët perëndimore malore dhe kodrinore dhe kjo jo vetëm në pjesët që përfshijnë kufijtë administrativ, por edhe në pjesët e Drenicës së Epërme, me tê cilên Lipjani është afërsisht i vetmi vendbanim me karakter qyteti.

Në anën tjetër si shembull i gravitimit tê Drenicës Jugore krahas Lipjanit, krijohet lëvizja e lirë natyrore. Nga kjo del se Lipjani —pozita gjeografike e tij, paraqet aspekt tê gjerë dhe me interes ne raport me qendrat rnë tê mêdha.

**1.1. Pozita gjeografike**

Komuna e Lipjanit ndodhet në pjesën qëndrore të Republikës së Kosovës, në jug të kryeqytetit të vendit (Prishtina), ku ndahen rrugët kryesore të rajonit. Ajo kufizohet me komunat: Ferizaj, Fushë Kosovë, Graçanicë, Prishtinë, Drenas, Suharekë, Malishevë, Shtime, Ferizaj, Gjilan dhe Artanë.

Në Komunën e Lipjanit jetojnë 57,605 banorë, dhe gjithsejt 62 venbanime ku në zone urbane jetojne rreth 17% e pupullsise apo 6780 banorë dhe pjesa tjetër prej 50735 banoreve jeton në zonat rurale - në fshatra. Sipërfaqja e Komunës është rreth 338km$^2$, me një dendësi të popullsisë rreth170 b/km$^2$, ku dendësia mesatare e popullsisë në shkallë vendi është 205 b/km$^2$.

Komuna e Lipjanit është një pikë strategjike për trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror, pasi aeroporti ndërkombëtar ndodhet në territorin e saj dhe është larg vetëm 15km nga qendra. Në anën perëndimore shtrihet rezervati Blinaja, ku ka potencial për t'u kthyer në një qendër rekreative dhe atraktive për tërë rajonin. Në vendbanimin Gadime gjendet Shpella e mermerit që paraqet një atraksion të rëndësishëm turistik jo vetëm për Komunën e Lipjanit, por për tërë Kosovën. Parku kulturo-historik në Kleçkë dhe Divjakë, si dhe qyteza e vjetër Janjeva, e cila po ashtu konsiderohet si vend atraktiv për vizitorët.

Komuna e Lipjanit ka 62 vendbanime, ku numri më i madh i tyre janë të koncentruar në fushëgropën e Kosovës, në pjesën qendrore të Komunës së Lipjanit. Vendbanimet e tjera shtrihen në pjesën lindore dhe perëndimore të Komunës.

Gjithashtu, Komuna gjendet në distancë shumë të afërt me qendra të tjera të mëdha të Republikës së Kosovës si: 16km nga Prishtina, 57km nga Mitrovica, 60km nga Prizreni, 96km nga Gjakova, 96 km nga Peja, 26km nga Ferizaj 50km nga Gjilani.

Qyteti i Lipjanit është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme 25/E 752 dhe 2/E 65, dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup.

Me konceptin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor, Kosova është ndarë në katër zona të cilat janë caktuar në bazë të tipareve që janë karakteristike për këto zona.
Zona ku bënë pjesë Komuna e Lipjanit: Porti i Kosovës (Hapësirë e kaltër) – Zonë administrative, arsimore, shëndetësore, shërbyese tregtare, industri e lehtë, agro-industriale, turistike. Kjo tërësi paraqet pjesën verilindore të Kosovës të përbërë përpos Lipjanit edhe nga komunat: Prishtina, Obiliqi, Podujeva, F. Kosova, Drenasi dhe Shtime në qendër me qytetin e Prishtinës.

Vizioni i Portit të Kosovës: me Vizion të zonës parashihet si një Zonë e gjallë dhe me prosperitet, ku qytetet duke përfshirë edhe Lipjanin tentojnë zhvillimin e vazhdueshëm të planifikuar urban, konkurrent me qytetet tjetra të zonës e në të njëjtën kohë të bashkuara e kooperative, atraktive për të jetuar dhe punuar në to.
Në qendër të zonës së kaltër (trekëndëshi Lipjan-Fushë Kosovë –Prishtinë), parashihet të zhvillohet Trekëndëshi i Zhvillimit Ekonomik të Kosovës, si kurriz i zhvillimit ekonomik me interes kombëtar, burim i të ardhurave për ekonominë kosovare si dhe zonë e mundshme për investitorët e kompanive ndërkombëtare.

Territori i Komunës së Lipjanit gjendet në lartësinë mbidetare mbi 500m ose 43.0 % të sipërfaqeve (bruto) gjinden në pjesën e rrafshët do të thotë gjer në 600 m të lartësisë mbidetare të cilat janë edhe më të përshtatshme për prodhimtarinë bimore. Kështu që në kuadër të këtyre sipërfaqeve gjendet numri më i madh i vendbanimeve, rrugëve, objekteve ekonomike dhe objekteve të tjera si dhe lumenjve me degët e tyre të cilat përfshijnë rreth 6 % të territorit të përgjithshëm të Komunës. Qyteti i Lipjanit shtrihet në mes të rrafshit të Fushë Kosovës në një lartësi përafërshisht rreth 550 m. majet më të larta në lindje dhe perëndim së bashku arrijnë mbi 1000m.





Pozicioni i Lipjanit në hartën e Republikës së Kosovës

## 2. Kushtet klimatike

Klima e Komunës së Lipjanit është mjaft e ngjashme me klimën e Komunës së Ferizajt dhe Shtimes, si komuna të cilat ndodhen në qendër të territorit të vendit. Ajo ka një klimë të mesme kontinentale me dimra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta. Sipas të dhënave të IHMK (Instituti Hidrometerologjik të Kosovës), muajt më të nxehtë të vitit janë Korriku dhe Gushti me një temperaturë mesatare 20.5-20.6 gradë celcius, ndërsa muaji më i ftohtë është Janari me temperaturë mesatare -1.4 gradë celcius. Temperatura mesatare vjetore vlerësohet të jetë 10 gradë celcius, ndërsa në zonat malore temperatura zbret deri në -9 gradë celcius. Maksimumi absolut i temperaturës është arritur në muajin Gusht rreth 37.3 gradë celcius, ndërsa më e ulta gjatë muajit Janar rreth -26 gradë celcius.

Lagështia mesatare vjetore e ajrit vlerësohet të jetë rreth 74.7%. Muaji Gusht është muaji më i thatë me një lagështi rreth 63%, ndërsa Janari është muaji me lagështinë më të madhe 86.1%[1].
Në këtë regjion vrentësimi mesatar vjetor është 57%, ku gjatë së cilës frekuenca e ditëve të kthjellta është 57.9, të cilat përbëjnë rreth 15.9% të ditëve të vitit[2].

Sasirat e të reshurave në këtë rajon janë të shpërndara në mënyrë jo të barabartë, ku kemi një sasi mesatare vjetore rreth 673.3mm[3]. Në komunën e Lipjanit shpesh herë të reshurat në formën e breshërit kanë shkaktuar dëme në ekonominë lokale të vendit, ndërsa reshjet e dëborës nuk paraqesin ndonjë problem në komunë, pasi ato janë në sasi të mëdha vetëm në zonat malore.
Frekuencën më të madhe vjetore në këtë rajon e kanë erat verilindore me 226 0/00 ndërsa më pak e kanë erërat lindore (E) me gjithësej 360/00. Shpejtësinë mesatare më të madhe e kanë erërat jugperëndimore me 4m/sec.[4]

Komuna Lipjanë shpesh herë ballafaqohet më problemin e vërshimeve si në lokalitetet e banuara ashtu edhe në tokat bujqësore, të cilat gjatë viteve të fundit kanë shkaktuar shumë dëme si:

- Dëmet ekonomike
- Rrezikimi i shëndetit të njeriut
- Ndotje permanente e ambientit

### 2.1. Karakteristikat sizmike

Sipas të dhënave të mëhershme Lipjani dhe rajoni më i gjerë, ndodhet në zonën e tetë sizmike,që duhet të merret parasysh gjatë zhvillimit të mëtejmë të vendbanimeve.

## 3. Pedologjia dhe gjeologjia

Në territorin e komunës së Lipjanit gjenden 22 tipe tokash me një numër të madh nëntipesh. Tipet më të përfaqësuara janë smonicat më tepër se 25.24%. Këto toka janë mjaft të mira, të thella, kryesisht të përbërjes së argjilit, neutrale, të pasura me humus dhe kalium aktiv, por jo mjaft të pasura me fosfor aktiv dhe kanë pjellori mjaft të madhe potenciale. Ndërkohë në komunë ka edhe disa toka të tjera si:

- Smonicat pa karbonate, të cilat dallohen me mundësinë e dobët të lëshimit të ujit e posaçërisht në shtresën punuese, dhe reaksionit të dobët të thertë, prandaj kanë vlerë më të vogël bujqësore se sa smonica karbonate. Këto toka dhe smonicat e lëshuara kërkojnë masa përmirësuese si rregullimit të regjimit ujor-ajror, dhënien e sasive më të mëdha të fosforit në tokë etj.

---

[1] IHMK (Instituti Hidrometerologjik i Kosovës)
[2] IHMK (Instituti Hidrometerologjik i Kosovës)
[3] IHMK (Instituti Hidrometerologjik i Kosovës)
[4] IHMK (Instituti Hidrometerologjik i Kosovës)

- Smonicat e eroduara dhe smonicat e kafenizuara me pseudoglej, të cilat gjenden në territore më të larta malore, prandaj erozioni i eroduar ka çuar pjesërisht një pjesë të horizontit humusor, duke i bërë këto toka gjysmë të thella deri të cekëta.
- Tokat aluviale përfaqësojnë rreth 22.87% të sipërfaqes, dhe kryesisht këto toka gjenden rreth degëve të lumit "Sitnica". Këto janë toka me veti të përshtatshme fiziko-ujore dhe me vlerë të lartë bujqësore. Në këto toka organizohet prodhimtari intensive bujqësore.
- Tokat e kafenizuara të cekëta në rrasat shkëmbore-ranore janë të përfshira me rreth 5.67% dhe tokat e kafenizuara të mesme të thella në rrasat shkëmbore-ranore përfshinë 8.54%. Këto toka dhe tokat e tjera të kafenizuara gjenden në terrenet e larta dhe kryesisht janë toka pyjore nën pyje.
- Tokat livadhore – teltynore dhe tokat livadhore-argjillore janë të përfaqësuara me rreth 3% dhe gjenden kryesisht përreth lumit "Sitnica".
- Tokat podzole-pseudoglej janë toka, të cilat e kanë vlerën e kufizuar bujqësore për shkak të cilësive (vetive) të këqija ujoro-fizike dhe shtresën punuese e cila nuk e lëshon ujin, dhe ka përmbajtje të madhe argjillore. Në mënyrë që këto toka të shfrytëzohen intensivisht në bujqësi është e nevojshme që të bëhen masat agromelioruese.
- Tokat deluviale përfshinë 5.36% nga territori i përgjithshëm i komunës.

Në Komunën e Lipjanit ka pothuajse të gjitha lëndet e para minerale, madje në sasi dhe cilësi të lartë[5].



Pjerrtesia e terenit

[5] Lidhur me këte, të dhëna më të plota janë paraqitur më poshtë te pjesa "Sektori minerar".



Pedologjia

## 4. Infrastruktura teknike

Infrastrukturën e Komunës së Lipjanit e përbëjnë 650km rrugë nën menaxhimin e Komunës, prej tyre 461.65km rrugë lokale të asfaltuara që lidhin zonën urbane me atë rurale, 133.51km rruge te paisura me trotuare ne zonen urbane dhe rurale, 12km shtigje për çiklistë, 204.2km rrugë me ndriçim publik, 68% e ekonomive familjare , bizneseve dhe institucioneve jane te perfshira ne sistemin e ujesjellesit, 98.43% e ekonomive familjare, bizneseve dhe institucioneve janë të përfshira në sistemin e kanalizimit, 50.09% e Ekonomive familjare kanë qasje në sistemin e grumbullimit të mbeturinave dhe rreth 90ha hapësira të gjelbëruara. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve janë bërë nga buxheti i kormunës, por ka pasur mbështetje edhe nga donatorët e ndryshëm.





# 5. Infrastruktura sociale

## 5.1 Shëndeti publik

Organizimi i Kujdesit Parësor Shëndetësor në Lipjan bëhet në përputhshmëri të plotë me rregullativën ligjore të Ministrisë së Shëndetësisë sipas Konceptit të Mjëksësië Familjare. Bartës kryesor i këtij koncepti është Mjeku Familjar dhe Institucionet e Kujdesit parësor Shëndetësor sic janë Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF), Qendrat e Mjekësisë Familajre (QMF) dhe Ambulantat e Mjekësisë Familjare (AMF).

Kujdesi Parësor Shëndetësor (KPSH) në Komunën e Lipjanit është e organizuar përmes 12 institucioneve të KPSH- së që përfshijnë:

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare (QKMF) – institucioni themelor i KPSH;
Qendrat e Mjekësisë Familjare (QMF) - si njësi përbërëse të QKMF;
Ambulantat e Mjekësisë Familjare (AMF) – si njësi përbërëse të QMF;
Ndërsa rrjeti i këtyre institucioneve të Kujdesit Parësorë Shëndetësor përbëhet nga;
1 QKMF në qytetin e Lipjanit;
4 QMF– Shalë, Magure, Gadime dhe Janjevë;
7 AMF - Kraishtë, Dobrajë e Madhe, Rubovc, Banullë, Babush i Muhaxherëve, Smallushë dhe Sllovi.

Në Institucionet e Kujdesit Parësor Shëndetësor të Komunës së Lipjanit, janë të punësuar gjithsej 236 punëtorë. Nga ky numër 58 janë mjek të profileve të ndryshme, nga të cilët 25 janë specialistë të Mjekësisë Familjare, 18 doktor të mjekësisë, dy specilistë të pediatrisë, dy specialistë të gjinekologjisë-obstetër, një specialist i radiologjisë, pesë doktor të stomatologjisë, katër specialisë të stomatologjisë (ortodont, smundjet e dhëmbit dhe kirurgji orale) dhe një specialist i pneomoftiziologjisë.
Si kuadër i mesëm shëndetësor janë gjithsej 130 punëtor, nga ky numër 12 janë teknik të laboratorit, 12 mami, 4 teknik të farmacisë, 4 teknik të stomatologjisë dhe 98 infermier.
Në administratë të IKPSH-ve janë të punësuar 12 punonjës. Përsonel mbështetës- teknik janë gjithsejt 36 punonjës.

## 5.2. Arsimi

**Struktura e rrjetit dhe niveleve shkollore**

Përbërja e rrjetit dhe niveleve shkollore në trevën komunale në Lipjan, ka shtrirje gjithëpërfshirëse në të gjitha vendbanimet e komunës. Struktura e niveleve është 0, 1, 2 dhe 3. Komuna e Lipjanit ka gjithësejt 30 institucione edukativo-arsimore amë me 33 paralele të ndara fizike, 30 në gjuhën shqipe dhe 3 në gjuhën serbe. Gjithësejt shkolla të mesme janë Gjimnazi ''Ulpiana'' në Lipjan me paralele të ndara në Shalë dhe Gadime, si dhe Shkolla e Mesme Profesionale '' Adem Gllavica në Lipjan.

Në kuadër të 28 institucioneve, kemi edhe shkollën speciale për nivelet e shkollimit 1,2 dhe 3 në Shtëpinë Korrektuese, QEA "Mehmet Akif" në Banullë, Qendra trajnuese në kuadër të SHMP" Adem Gllavica" – Norges Vel, si dhe Kampusin e UBT-së".

Numri i kopshteve 4, SHFMU -24, SHML 3

Numri i nxenesve nga vendbanimet urbane të cilët vijojnë mësimet në nstitucione arsmimore te nivelit ISCED 02 1, 2, dhe 3 .................4827 nxënës.

Numri i nxenesve nga vendbanimet rurale të cilët vijojnë mësimet në institucione arsmimore te nivelit ISCED 02 1, 2, dhe 3 .................7271 nxënës.

Numri i mësimdhënësve në nivelin parauniversitar është 821.

## 6. Trashëgimia kulturore

Monumentet e trashëgimisë natyrore dhe kulturore paraqesin pikat e atraksioneve turistike në komunën e Lipjanit. Gadimja si qendër ku ndodhet monumenti natyror "Shpella e mermert" paraqet një atraksion të veçantë kombëtarë dhe ndërkobëtarë me mundësi të mira të zhvillimit të zonës në tërësi duke u kombinuar me turizmin malor, kulturor, gjuetisë në malet e Zhegovcit si dhe me atraksionet tejra që dalin nga ndërtimi i liqenit të Gadimes (resurse të pasura natyrore (Uji, Uji termal dhe termo mineral, pyjet, biodiversiteti).

Trashëgimia kulturore në Janjevë, Kleçkë, Shalë, Gadimje, Lipjan etj.

Komuna e Lipjanit ka trashëgimi të pasur natyrore si peisazhe, monumente të natyrës, trungje të vjetra, monumente gjeomorfologjike etj. Po ashtu janë të theksuara edhe fenomenet gjeomorfologjike në Gadime, si Shpella e Mermert, Epigjenia e lumit Gadime, etj. Pastaj, trungje të vjetra, Kapacitetet për turizëm rinor dhe kongresial, në Janjevë arkitektura e vjetër e cila pas rikonstruimit dhe rehabilitimit është një mundësi ideale e zhvillimit të turizimit rural, pastaj mbajtja e orëve letrare "Shtjefën Gjeqovi" si dhe monumente dhe objekte tjera e bëjnë Janjevën një lokalitet me interes të veçantë turistik.

**Ligatina e Hencit Zone e mbrojtur e zogjëve e lokalizuar ndërmjet komunave F. Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan,** me një sipërfaqe prej 109 ha. Është zonë me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrologjike, botanike dhe peisazhore.

**Monumenti i Natyrës "Burimet e Ujit" në fshatin Baicë-** monument i natyrës me karakter hidrologjik me një sipërfaqe prej 5 ari. Gjithashtu janë vënë nën mbrojtje një numër i madhë i Monumenteve të Natyrës me karakter botanik si: "Trungu i Qarrit (Querqus cerris)" në fshatin Gadime e Epërme; Trungu i Bungbutës (Quercus pubescens)" në fshatin Dobrajë e Madhe, dhe kështu një mori vlera tjera botanike nëpër lokalitete të ndryshme të komunës së Lipjanit janë vënë nën mbrojtje sipa dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

**Flora –** Fitodiversitetit në komunën e Lipjanit shkon deri te brezi i ahishteve (Fagus silvatica) të përziera me bungë (Quercus petraea), ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me

shoqrime mjaft të mdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve, vendbanimeve, dhe në tokat djerrina.

**Fauna**- Komuna e Lipjanit karakterizohet me një zoodiversitet të pasur. Për rëndësinë e biodiversitetit shquhet Vend Gjuetia e Rëndësisë së Veçantë "Blinaja", me një llojllojshmëri të madhe të faunës. Ky rezervat shtrihet në një sipërfaqe prej 2795ha. Llojet kryesore të faunës së egër në Blinajë janë: Derri i egër (Sus scrofa) - me rreth 500 krerë, Dreri i kuq (Cervus elaphus) - rreth 150 krerë, Dreri i murrmë (Dama dama) - rreth 100 krerë, Kaprolli (Capreolus capreolus) - rreth 170 krerë. Lloje tjera prezentë janë edhe Vjedulla (Meles meles), Shqarthi i ahut (Martes sp.), Shqarthi i pishës evropiane (Martes sp.), Lepuri (Lepus europeus), Korbi (Corvus corax), Laraska (Pica pica), Shqiponja minj ngrënëse (Buteo buteo), Rosa e egër (Anas querquerdula), Macja e egër (Felis sylvestris), Ketri (Sciurus vulgaris), etj.

| ZONAT E MBROJTURA NË LIPJAN SIPAS KATEGORIVE | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | EMËRTIMI I ZONËS | SIPËRFAQJA NË HA | VITI I MBROJTJES | KATEGORIA IUCN | PËRSHKRIMI ZONËS |
| 1. | Shpella e Gadimes | 55,00 | 1969 | III | Gjeomonument i natyrës i pasur me stoli natyrore, është ndër shpellat më të bukura në Kosovë, Ballkan dhe më gjerë me rendësi shkencore, edukative, arsimore dhe turistike. |
| 2. | Parku i Blinajës | 5500ha | 1955 | | Territori i Blinajës shtrihet 15 km në perëndim të qytetit të Lipjanit. Sipërfaqja e Blinajës shtrihet në territorin e tri komunave: Lypjan, Shtime dhe Drenas. Lartësia mbidetare është prej 670 – 860 m. Prania e 33 liqeneve dhe 60 livadheve krijon peizazhe të bukura dhe të ndryshme të cilat e bëjnë Blinajën shumë atraktive dhe tërheqëse për studiues dhe vizitorë dhe njëherit ofron kushte të volitshme për ekzistencën e shumë llojeve bimore dhe shtazore. |
| 3. | Zonë e veçantë e mbrojtur e Zogjve | 109.5 | 2014 | | Zona me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogeologjike, botanike dhe peisazhore |

TABELA 8: LISTA E VLERAVE TË TRASHËGIMISË KULTURORE SIPAS LISTËS SË PËRKOHSHME TË MKRS10

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| KATEGORIA - TRASHËGIMI ARKEOLOGJIKE / NËNKATEGORIA: LOKALITET ARKEOLOGJIK/REZERVAT | | | | |
| NR. | NR. [illegible] | EMERTIMI | PERIUDHA | VENDI- KOMUNA |
| 1. | 691 | Qyteza Parahistorike (Gadime) | Parahistori | Gadime e Eperme Lipjan |
| 2. | 3031 | Lokaliteti Arkeologjik "Ogragje" | Antikitet i Vone, Mesjete | Rubofc, Lipjan |
| 3. | 3032 | Germadhat e Lokalitetit Arkeologjik Antik "Stacio Herculana" | Romake | Gushterice e Larte dhe e ulet, Lipjan |
| 4. | 42 | Qyteza ne Klecke | Antikitet i Vone | Klecke, Lipjan |
| 5. | 684 | Qyteza "Kodra e Qytetit" | Parahistori, Mesjete | Bajice, Lipjan |
| 6. | 3697 | Gjurmët e Qytetit te Janjeves | Antikitet i Vone | Janjeve, Lipjan |
| 7. | 3708 | Lokalitet arkeologjik i kohës romake ne Torina | Romake | Torina, Lipjan |
| 8. | 3712 | Lokalitet arkeologjik ne Babush te Muhaxhereve | Romake | Babush te Muhaxhereve |
| 9. | 2905 | Gërmadhat e kishës se Shen Gjonit ne Silovi | Mesjete | Silovije, Lipjan |
| 10. | 2906 | Gërmadhat e kishës se "Shen Nikolles" | Mesjete | Silovije, Lipjan |
| 11. | 2907 | Germadhat e Manastirit mesjetare Shen Gjergji ne Silovi | Mesjete | Silovije, Lipjan |
| 12. | 2912 | Kishe varrezore e fshatit ne Toplican | Mesjete | Toplican, Lipjan |
| KATEGORIA - TRASHËGIMI ARKITEKTONIKE / NËNKATEGORIA: MONUMENT/[illegible] | | | | |
| NR. | NR. [illegible] | EMERTIMI | PERIUDHA | VENDI- KOMUNA |
| 13. | 2903 | Kisha e Shpalljes se Virgjëreshës, Lipjan | Shek. XIV | Lipjan |
| 14. | 2904 | Bunkeri i UNÇ - së - Vrrellë | Shek. XX | Vrellë – Lipjan |
| 15. | 2911 | Tyrbja e Isak Babës | Shek. XVIII | Teqe - - Lipjan |
| 16. | 2913 | Shkolla fillore në gjuhën Serbe - 1882 | Shek. XIX | Gushtericë e Epërme-Graçanicë |
| 17. | 2760 | Xhamia në Shalë (Sedllarë) | Shek. XVIII | Shalë (Sedllarë) |
| 18. | 36 | Shtëpia Muze e At Shtjefën Gjeçovit | Shek. XX | Janjevë |
| 19. | 43 | Kulla e Pashës Karadakut - Janjevë | | Janjevë – Lipjan |
| 20. | 41 | Shtëpi me ballkon –Glasnoviq Josipa Maria. | | Janjevë - Lipjan |
| 21. | 44 | Xhamia e Janjevës | Shek. XVII | Janjevë – Lipjan |
| 22. | 4293 | Bunari i familjes Olluri | | Krojmir, Lipjan |
| 23. | 76 | Xhamia ne fshatin Llugaxhi | | Llugagji- Lipjan |
| 24. | 4655 | Shtëpi banimi, ish-Selia e shtabit te brigadës 121- "Komandant Kumanova" | | Krojmir, Lipjan |
| 25. | 4685 | Shkolla shqipe Banullë | | Banullë-Lipjan |

# III. PRESIONET NE MJEDIS

## 1. Popullsia dhe vendbanimet

Lidhur me popullsinë, burimet njerëzore dhe tregun e punës, janë me rëndësi të veçantë të bëhen analiza socio-ekonomike, meqenëse në të shumtën e rasteve të dhënat ekzistuese statistikore janë të pamjaftueshme, për shkak se nuk ofrojnë informata të sakta sa i përket numrit të banorëve se ku jetojnë, vendit ku jetojnë jashtë Komunës së Lipjanit dhe nuk ofrojnë të dhëna se sa banorë të komunave të tjera punojnë në Komunën e Lipjanit.

Bazuar në regjistrimin e fundit të vitit 2011, Komuna e Lipjanit ka gjithsej 57605 banorë. Duke iu referuar territorit dhe numrit të banorëve, Komuna e Lipjanit radhitet si Komuna e tretë në Kosovë për nga madhësia.

Në Komunën e Lipjanit dendësia e popullsisë është mesatarisht rreth 170 banorë për km2 . Rreth 17% e popullsisë, banojnë në zonën urbane dhe 83% në zonën rurale. Për nga

përkatësia etnike, shqiptarë 54667 banorë, serb 513, turq 128, boshnjak 42, rom 342, ashkali 1812, Egjiptian 4, të tjerë 260, të papërcaktuar 31.

Në bazë të regjistrimit te popullsisë nga ana e Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) të kryer më 2011, numri i banorëve është 57,605.

| Popullsia në Komunen e Lipjanit | Gjithsejtë | Etniteti | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shqiptarë | serb | turq | boshnjak | rom | ashkali | egjiptian | të tjerë |
| Total | 57,605 | 54467 | 513 | 128 | 42 | 342 | 1812 | 4 | 291 |

Tabela 1: Popullsia në komunën e Lipjanit sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës 2011

| Regjistrimi ASK 2011 | | Vlerësimi ASK 2021 | |
|---|---|---|---|
| Numri i populates | Numri i amvisërive | Numri i populates | Ngritje / zbritje % |
| 57,605 | 9,497 | 57,457 | - 0.3 % |

Tabela 2: Migrimi për vitin 2021 në Komunën e Lipjanit

| Gjthësej popullsia e vlerësuar (31 dhjetor 2020) | Migrimi ndërkombëtar 2021 | | | Migrimi Kombëtar 2021 | | | Bilanci i përgjith-shëm i migrimit | Gjithëse j popullës ia dhe migrimi 2021 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i migrimit ndërkomb-ëtar | Imigrimi | Emigrimi | Bilanci i Migrimit Kombëtar | | |
| 57,928 | 127 | 1,186 | -1,059 | 221 | 306 | -85 | -1,144 | 56,784 |

Rreth 88% jetojnë në vise rurale, kurse vetëm rreh 12% nëpjesën urbane. Dendësia e popullsisë është 170 b/km2, e përafërt me mesataren e popullsisë në shkallë vendi 205 b/km2.

Mosha e popullsisë është e re, nga kjo rreth 40% janë të moshës 0 -14 vjeç, 45% janë të moshës 15 - 65 vjeç dhe 15% janë të moshës mbi 65 vjeç.

Në lidhje me madhësinë e familjeve janë bërë disa hulumtime demografike gjatë vitit 2002 dhe gjatë vitit 2003, ku është vlerësuar që madhësia mesatare në Republikën e Kosovës është 6.4 persona/familje, 6.8 persona/familje për zonat rurale dhe 5.5 persona/familje për zonat urbane. Në rastin e Komunës Lipjan madhësia mesatare e personave në familje vlerësohet të jetë 5 persona/familje. Numri i meshkujve në komunën e Lipjanit është 29,23, kurse numri i femrave 28, 285.

Duke iu referuar hartes Zonale të Komunes së Lipjanit nga fusha e banimit teritori i Komunes eshte planifkuar në Zonat e banimit si:

- Zona rurale me intenzitet të ulët ku bëjnë pjesë 55 vendbanime: Akllap, Babush i Muhaxherve, Baicë, Banullë, Breg i Zi, Brus, Bujan, Bukovicë, Divlakë, Dobrajë e Madhe, Dobrajë e Vogël, Gadime e Ulët, Gllanicë, Gllavicë, Gllogoc, Grackë e Vjetër, Grackë e Vogël, Gumnasellë, Hallaç i Madh, Hallaç i Vogël, Hanroc, Kleqkë, Kojskë, Konjuh,

Kraishtë, Krojmir, Leletiq, Lipovicë, Llugagxhi, Llugë, Marec, Medvec, Mirenë, Okosnicë, Plitkoviq, Poturoc, Qellapek, Qylagë, Resinoc, Ribar i Madh, Ribar i Vogël, Rubofc, Rufc i Ri, Rufc I Vjetër, Smallushë, Shisharkë, Teqe, Tërbufc, Topliçan, Torinë, Varigoc, Vërshec, Vogaçicë, Vrellë, Vrellë e Goleshit, dhe Zllokuqan me gjithsejt 37959 banore (regjistrimi ASK 2011).

- Zona Sipërfaqe rurale me intenzitet të lartë përfshinë 5 qendra të rendit të ulët: Janjevë, Sllovi, Shalë, Gadime dhe Magure.... Gjithsejt 12393 banorë.
- Sipërfaqe suburbane perfshin zonen perferike te qytetit te Lipjanit.
- Sipërfaqe urbane e përgjithshme- zonen urbane.
- Sipërfaqe urbane qendrore – pjesa qendrore e qytetit.




Dendësia e popullsisë

## 1.1 Punësimi dhe papunësia

Niveli i punësimit në Komunën e Lipjanit është mjaft i ulët, krahasuar me numrin e popullsisë aktive për punë.
Numri i të punësuarve në sektorin publik është 1525 (administratë 220, shëndetësi 240 dhe arsim 1065), kurse në sektorin privat numri i të punësuarve është rreth 11580[6].
Aktualisht në Komunën e Lipjanit veprojnë (janë aktive) rreth 3812[7] biznese.
Papunësia në Komunën e Lipjanit është afër 26%.

## 2. Industria dhe Bizneset

Komuna e Lipjanit me shtrirjen gjeografike që ka, dhe me resurset natyrore ka një potencial të madh për zhvillim ekonomik.
Në komunen e Lipjanit veprimtarit kryesore sipas bizneseve që operojn jan tregtia , transporti, prodhimi, ndertimtaria, hoteleria dhe të tjera. Shumica e bizneseve jan të orientuara në tregti që në përqindje sillet rreth 50%, transporti me 17.6%; prodhimi 8.7%; nëdërtimtaria 10% hoteleria me

[6] Sipas të dhënave nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim – maj 2022.
[7] Sipas të dhënave nga Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim – maj 2022.

7.0% të tjera me 10.4%. Aktualisht në Komunën e Lipjanit veprojnë (janë aktive) rreth 4519 biznese

Meqenëse komuna e Lipjanit posedon në pronësi të veten siperfaqe relativisht t mëdha të tokës, kjo i mundson komunës investime të perbashkëta me partneritetin publiko-privat. Në këtë kuptim komuna ka shpallur tri zona ekonomike: Zona ekonomike në fshatin Konjuh, Zona ekonomike-parku industrial në zonën kadastrale në Qylagë (562,456m2) Zona Ekonomike në Babush si dhe Zonat komerciale ne qytet dhe jasht qytetit te cilat janë te koncentruara kryesisjht ne kuader te koridoreve rrugore rajonale dhe magjistrale.

Në zhvillimin ekonomik të komunës së Lipjanit një ndikim të madh ka edhe turizmi, pasi siq dihet n komunën e Lipjanit ndodhen disa atraksione turistike siq janë: Shpella e Gadimes, lokaliteti i Janjevës si vendbanim i vjetër, ujerat termale në fshatin Baicë, pylli i mbrojtur "Blinaja", gryka e Shalës, Zona e Interesit të Veçantë "Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-ës Kleçkë dhe Divjakë" etj.

**Bizneset sipas ARBK**

| Lipjan | Biznes individual | Kompani e huaj | Kooperativa bujqesore | Ndrmarrje publike | Ndërmarrje shoqërore | Ortakëri | Ortakëri e përgjithsme | Shoqri aksionare | Sh.p.k | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 3,750 | 22 | 2 | - | 1 | 1 | 104 | 3 | 636 | 4519 |

## 2.1. Sektori minerar

Në Komunën e Lipjanit ka pothuajse të gjitha lëndet e para minerale, madje në sasi dhe cilësi të lartë. Më të rëndësishme janë lëndet e para minerale energjetike dhe pikërisht linjiti. Lëndet e para minerale të metaleve, rezervat e xehes së Nikelit, pjesërisht Hekurit, Kromit, Kobaltit etj, pastaj kemi rezervat e lëndëve të para jometalore, rezervat e magnezitit, duniteve, materialeve të ndërtimit, gëlqerorëve, rërave kuarcore, rërave dhe zhavoreve.etj.

Mineralet e jometaleve kanë një përhapje të konsiderueshme në komunën e Lipjanit të cilat gjithashtu janë të dislokuara në pjesën lindore dhe përendimore të Lipjanit. Në afërsi të vendbanimit Medvec gjendet vendburimi i Duniteve, Rëra kuarcore në vendburimin, Llozishtë'' në Sllovi, vendburimi i Magnezitit në "Golesh"- Magurë, vendburimi i mermereve të dolomitizuara në Babush të Muhaxherve, vendburimi i shkëmbit gëlqeror në Shalë, vendburimi i gëlqerorëve të mermerizuar "Mirena''- Mirenë, vendburimi i gëlqerorëve, "Baicë''-Baicë. Rezerva të konsiderueshme të shkëmbit gëlqerorë në komunën e Lipjanit ndodhen edhe në vendbanimet Krojmir, Baicë në Malet e Blinajës (Lipovicë) të cilat do të kenë një perspektivë në të ardhmen për komunën e Lipjanit.

## 3. Transporti

Komuna e Lipjanit është e pozicionuar në qendër të Republikës se Kosovës. Komuna e Lipjanit është një pikë strategjike për trafikun rrugor, hekurudhor dhe ajror.

Qyteti i Lipjanit është i pozicionuar në udhëkryqin në mes të dy rrugëve të rëndësishme 25/E 752 dhe 2/E 65, dhe të hekurudhës kryesore Mitrovicë-Shkup, kurse aeroporti ndërkombëtar ndodhet në territorin e tij dhe është larg nga qendra vetëm 15km.

Infrastruktura rrugore përfshinë sipërfaqe prej 342 ha nga territori i komunës së Lipjanit.

Rrugët publike
Duke u bazuar ne UA për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, rrjeti i infrastrukturës rrugore, sipas përgjegjësive për mirëmbajtje dhe ndërtim, ndahet në rrjet kombëtar dhe rrjet lokal të infrastrukturës rrugore.

Rrjeti kombëtar i infrastrukturës rrugore
Përgjegjës i planifikimit, realizimit dhe mirëmbajtjes i këtij rrjeti është niveli qendror i qeverisjes dhe karakterizohet me kategoritë e rrugëve si:
- autoudhët:
- rrugët nacionale:
- rrugët rajonale:
- rrugë lidhëse:

Rrjeti lokal i infrastrukturës rrugore
Nen menaxhim të plotë nga Komuna e Lipjanit janë rrugët lokale të cilat përkufizohen si rrugë që lidhin vendbanimet rurale apo fshatrat; rrugët brenda vendbanimeve rurale; si dhe rrugët brenda vendbanimit urban (Qytetit Lipjan).

Përveç rrugëve te kategorizuara ne Komunën e Lipjanit paraqiten edhe Rruge te Pakategorizuara. Zakonisht këto nuk janë rrugë publike, por shfrytëzohen për komunikacion si rruga për shfrytëzimin e pyjeve, rruga për destinim bujqësor e të ngjashme. Këto rruge nuk mirëmbahen nga Komuna e Lipjanit, por nuk është e limituar mundësia qe ne te ardhmen te rikategorizohen si pjese e rrjetit lokal te infrastrukturës rrugore dhe te marrin trajtimin dhe profilin përkatës.

Rrjeti rrugor lokal i komunës së Lipjanit lidhet me rrjetin e rrugëve nacionale përmes rrugëve Prishtinë-Prizren dhe Prishtinë Ferizaj.
Kryqëzimet kryesore në komunë janë në Banullë në drejtimin për Ferizaj dhe Janjevë si dhe kryqësimi i rrugës Prishtinë - Prizren me rrugën regjiionale Lipjan – Magure.

Rrugët lokale ofrojnë lidhje shumë të mirë në mes të vendbanimeve në zona rurale si dhe me qytetin e Lipjanit. Rrugët lokale janë kryesisht në gjendje të mirë, megjithatë një pjesë e tyre janë të ngushta dhe plotësisht ju mungon infrastruktura përcjellëse siç janë pushimoret, shtigjet për këmbësorë apo biçikleta duke paraqitur një sfide serioze për këmbësorët dhe përdoruesit e mjeteve të pa motorizuara. Me fokus të veçantë duhet te trajtohen ato segmente të rrugëve që kalohen nga fëmijët në baza ditore (shtëpi-shkollë-shtëpi) apo segmentet nga njëri fshat në tjetrin.
Zhurma dhe pluhuri janë dukuri te zakonshme që rrjedhin si pasojë e lëvizjes së automjeteve të rënda. Këto dukuri janë të shfaqura në veçanti tek rrugët regjionale dhe nacionale.

Rrjeti hekurudhor
Hekurudha kryesore Mitrovicë/Fushë Kosovë dhe Ferizaj/Shkup kalon në mes të Lipjanit me stacionin e pasagjerëve dhe trafikut të mallrave, me një gjatësi prej 8.9km.

Transporti ajror
Aeroportit Ndërkombëtar ''Adem Jashari'' shtrihet në territorin e komunës së Lipjanit.

Transporti publik
Për komunën e Lipjanit, gjegjësisht në qytet, inkurajohet krijimi i rrjetit te transportit urban. Lloji, lokacionet dhe kushtet për pike-ndalesat duhet te përcaktohen me rregullore te veçantë.
Momentalisht shërbime të transportit publik kanë të gjitha vendbanimet e mëdha dhe fushore, ndërsa vendbanimet e largëta kodrinoro-malore të tipit të shpërndarë dhe me numër të vogël të banorëve nuk kanë shërbime të transportit publik. Këto vndbamie janë: Kleçka, Divjaka, Vrella, Plitkoviqi, Tërbuvci, Brusi, Kosnica, Vogoçica dhe Shishari. Transporti publik ndërmjet qytetit dhe vendbanimeve e përmendura duhet te zgjerohet dhe ti shërbej nevojave të qytetarëve.

## 4. Bujqësia

Komuna e Lipjanit karakterizohet si vend bujqësor, edhe mëtutje bujqësia është degë e rëndësishme e ekonomisë në nivel komunal.

Në përgjithësi rreth 60% e popullatës në Komunën e Lipjanit merren me bujqësi. Një pjesë e madhe e popullatës jeton në mërgim ku edhe krijon të hyra të mjaftueshme për disa familje. Tokat pjellore shtrihen në pjesën e rrafsht të komunës, rreth lumenjëve dhe prrockave dhe kryesisht shfrytëzohen për bujqësi, me një trend të rritjes së shndërrimit të tokave pjellore në ato ndërtimore dhe sipërfaqe të pa mbjellura (djerrina). Në këtë aspekt mungojnë hulumtime përkatëse për sasinë e shfrytëzimit të tyre.

Komuna e Lipjanit ka pozitë mjaft të përshtatshme gjeografike sepse gjendet në pjesën qendrore të Kosovës dhe në udhëkryqin e rrugëve më të rëndësishme në Kosovës. Komuna e Lipjanit, pjesa dërmuese e teritorit ndodhet në fushëgropën e basenit të Kosovës, e cila karakterizohet me toka të prodhimtarisë së lartë.

Përmes territorit të Komunës rrjedh lumi "Sitnica" përreth dhe përgjatë së cilit shtrihen sipërfaqet më të pëlleshme bujqësore, mbi të cilat mëtej shtrihen gjithashtu sipërfaqe të mëdha të fushave mjaftë të pëlleshme dhe të përshtatshme për prodhimtari bujqësore intensive.

Duke u nisur nga fakti se bujqësia është dega e dytë ekonomike për nga rëndësia, dhe se prodhimi i ushqimit ka rëndësi strategjike për shoqërinë tonë, në planin ekonomik të zhvillimit të komunës për periudhën e ardhshme, zhvillimit të bujqësisë duhet dhënë një rëndësi prioritare.

Me analizimin e faktorëve që ndikojnë në zhvillimin më të shpejtuar të prodhimtarisë bujqësore, është konstatuar se një ndër faktorët me rendësi limituese është toka e pa rregulluar, të cilën e karakterizojnë ngastrat e vogla dhe të shpërndara të ekonomisë në sektorin individual. Kjo gjendje e tokës nuk mundëson aplikimin e masave bashkëkohore agroteknike në masë të duhur dhe përdorimin e makinave dhe stabilimenteve tjera në procesin e prodhimtarisë në formë racionale

Lavërtaria është dega më e rëndësishme e bujqësisë sepse siguron ushqimin kryesor të njerëzve, një pjesë të ushqimit për kafshë, dhe një pjesë të konsideruar të lëndëve të para për industri për qëllime të ndryshme, si vajra, lëndë djegëse, pije alkoolike, stimulansë, ngjyra, erëza etj.

Rajoni i Komunës së Lipjanit ka klimë të mesme kontinentale me dimra relativisht të butë dhe verëra mesatarisht të nxehta. Temperatura mesatare vjetore është 9.6 – 100C, që është e mjaftueshme për kultivimin e një numri më të madh të kulturave bujqësore.






Zonat bujqësore

TABELA 2: TABELA E SHFRYTËZIMIT TË TOKËS E PËRDITËSUAR GJATË PUNËS NE HZK

| Kodi Hiluc 2 | Klasa Hiluc 2 | Kodi Hiluc 3 | | Sip Ha | % |
|---|---|---|---|---|---|
| 5 | Banim | 5.1 | Banim i përhershëm: shtëpi të veçanta, shtëpi dyshe dhe në varg | 3195.5 | 9.4 |
| | | 5.1 | Banim i përherëshëm – ndërtesat e banimit me shumë njësi | 79.5 | 0.2 |
| 1.1 | Bujqësi | 1.1.1<br>1.1.3 | Prodhim bujqësor komercial; Prodhim bujqësor për konsum vetjak | 14,347 | 42.4 |
| 1.2 | Pylltari | 1.2.3 | Pylltari e bazuar në mbulesë të vazhdueshme | 13,350 | 39.4 |
| 2.1 | Industri e lëndës së parë | / | / | 376.7 | 1.1 |
| 2.3 | Industri e prodhimeve të lehta | / | / | | |
| 1.3 | Miniere dhe Gurore | 1.3.3 | Miniera dhe gurore tjetër | 333 | 1.0 |
| 4.1 | Rrjetet të transportit | 4.1.1 | Infrastrukture e transportit rrugor | 698 | 2.1 |
| 4.1 | Rrjetet të transportit | 4.1.2 | Infrastrukture e transportit hekurudhor | 20.5 | 0.1 |
| 4.1 | Rrjetet të transportit | 4.1.3 | Infrastrukture e transportit Ajror | 412 | 1.2 |
| 3.3 | Shërbim i komunitetit | 3.3.1 | Shërbim i administratës publike, mbrotjës dhe sigurisë sociale | 81.7 | 0.2 |
| 3.3 | Shërbim i komunitetit | 3.3.2 | Shërbim arsimor | 52.1 | 0.2 |
| 3.3 | Shërbim i komunitetit - | 3.3.3 | Shërbim shëndetësor dhe shoqëror | 3.8 | 0.0 |
| 3.3 | Shërbim i komunitetit - | 3.3.4 | Shërbim fetare | 57.4 | 0.2 |
| 3.3 | Shërbim i komunitetit - | 3.3.5 | Shërbim tjetër i komunitetit - Varreza | 87.8 | 0.3 |
| 3.3 | Shërbim i komunitetit - | 3.3.5 | Shërbim tjetër i komunitetit | 2.8 | 0.0 |
| 3.1 | Shërbimi tregtar | / | / | 538 | 1.6 |
| 3.4 | Shërbim kulturor, argëtues dhe rekreativ | / | / | 29.8 | 0.1 |
| 6.3 | Tokë natyrore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik | 6.3.1 | Tokë ujore e cila nuk është në funksion tjetër ekonomik | 183.4 | 0.5 |
| | TOTAL | | | 33,849 | 100 |

**Pyjet** – në komunën e Lipjanit pyjet shtrihen në perendim (rrafshlartat e Blinajës, Caralevës dhe Drenicës-Shalës) dhe në jug-lindje (Janjeva, Sllovi dhe Gadime). Një pasuri e veçantë pyjore ndodhet në vendgjuetinë e mbrojtur të rëndësisë së veçantë "Blinaja" ku kemi një zonë të madhe pyjore të mbrojtur e cila shtrihet në jugperëndim të komunës së Lipjanit. Në masivin malor të lokalitetit Gadime (kodra e murturit), ndodhet Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes", e cila ka një gjatësi prej 1400m.

Prej sipërfaqes së përgjithshme të pyjeve të në komunën e Lipjanit;

- 1621.023 ha janë pyje të larta,
- 2993.21 ha pyje të ulëta
- 11038.16ha janë shkurre.



**Zonat pyjore**

## IV. GJENDJA E MJEDISIT

### 1. Resurset ujore

Në aspektin hidrografik ujrat në komunen e Lipjanit i takojn pellgut të Detit të Zi, ndërsa lumenjët më të mëdhenjë janë lumi Sitnica dhe Drenica të cilët janë edhe nën degë të lumit Ibër. Në përgjithësi rrjeti hidrografik ka potencial ujor të varfër, i kushtëzuar nga sasia e vogël e reshjeve mesatare shumvjeçare (600mm). Lumi Sitnica është lumi më i madh në komunën e Lipjanit i cili degët më të zhvilluara hidrografike i ka në anën lindore si: Lumi Janjevka, Lumi i Zhegovcit, Lumi i Gadimës dhe Lumi i Sazlisë, ndërsa, në anën perendimore lumi më i zhvilluar është Lumi i Vërshevcit. Sipërfaqja ujore përbën 182 ha (1.1%) nga sipërfaqja totale e territorit të komunës së Lipjanit.

Sasitë më të mëdha të të reshurave janë gjatë muajit prill dhe maj, prandaj periudha pranverore është ajo kur paraqiten vërshimet dhe kur kemi edhe paraqitjen e kënetave, posaçërisht në tokat të cilat nuk e lëshojnë ujin.

Përmbytjet janë fatkeqësi elementare të cilat kërkojnë vëmendje të posaçme. Përmbytjet konsiderohen dukuri të cilat paraqiten në sezone të caktuara, të cilat janë të rrezikshme për jetën e njeriut dhe sjellin dëme të konsiderueshme materiale. Përmbytjet nuk mund të parandalohen, por dëmet e tyre mund të amortizohen dhe menaxhohen. Uji i cili grumbullohet nga reshjet ose shkrirja e bores patjetër duhet ta gjejë një rrugë të lëvizjes së tij. Në këtë rast është e rëndësishme që atij t'i krijohen kushte për një shkarkim sa më të lirë dhe pa pengesa.

Në komunën e Lipjanit është me rëndësi të trajtohen ujërat që shkaktojnë përmbytje e që vinë si rezultat i përrenjve në zonat malore, të cilët gjatë motit të lig me shira intensive bëhen shumë të rrëmbyeshëm dhe bartin materialet që e gjejnë në rrugën e tyre dhe kanë fuqi të madhe. Faktor tjetër mendikim në zonat e rrafshëta është mungesa e pjerrësisë së terrenit, prandaj uji i shiut ose nga bora e shkrirë nuk lëviz, por qëndron deri në momentin sa të thithet nga shtresa e tokës.

Aktualisht KUR „Prishtina" sh.a NjOU – Lipjan, e cila është ofruesi kryesor me ujë të pijshëm në komunën e Lipjanit, e cila ka këto të dhëna mbi përfshirjen e zonës së shërbimit; Ofron shërbime për qytetin e Lipjanit dhe 29 fshatra, me numër të konsumatorëve prej 38383, koha e shërbimit –

ofrimit të ujit të pijshëm është 24 orë, pa ndërprerje, me përjashtim të rasteve kur ka defekte apo probleme tjera (reduktimet e energjisë) në stacionin e pompave dhe tubacionet – rrjetin shpërndarës të ujësjellësit. Burimet e marrjes së ujit janë ujërat nëntokësore të cilat shfrytëzohen përmes puseve me anë të sistemit të pompimit thithës, këto puse ndodhen në zonën aluviale të lumit “Sitnica” (saktësisht në lokalitetint e ish fabrika e letrës dhe te livadhet e Sitnicës). Uji i ofruar për zonën e shërbimit të cilën e mbulon kjo njësi operative i plotëson standardet e ujit të pijshëm sipas rregullores, respektivisht standardeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH ) dhe rregulloreve dhe normave të IKSHP. Metoda e pastrimit, trajtimit – përpunimit të ujit është vetëm me sistemin e klorifikimit në stacionet e klorimit.

Prioritet: Mbrojtja e resurseve ekzistuese të ujrave:

Përmirësimi i mbrojtjes së burimeve ujore në sistemet rurale të ujërave.
KRU "Prishtina" sh.a Njesia Operative e Ujësjellësit në Lipjan ka afer 12000 konsumatorë të cilët furnizoheh nga keto burime nëntokësore në akuifer intergranular.
Lokacionet e puseve nëntokesore të cilët furnizohen qytetaret e Komunes se Lipjanit:
- Tetë (8) puse te ish fabrika e Letres (parcellat janë në pronë private) ekziston vendimi per mbrojtjen e zonave I, II dhe III;
- Tetë (8) puse te livadhet afer ETC (parcella është pronë e AKP);
- Gjashtë (6) puse te arat e Konjuhit (parcellat pjeserisht jane prone e Komunes) eshte ne proces vendimi per zonat mbrojtese I II III;
- Një (1) pus në Vrellë (parcela është pronë e Minieres së Magnezitit në Magure);
- Katër (4) puse Marec (parcelat janë në pronë private);
- Pesë (5) puse grumbulluese në Sllovi (parcellat janë në pronë private);
- Tri (3) puse në Qylagë që nuk janë të shfrytëzueshëm (parcella eshte pronë e Komunes);
- Burimet e ujit që nuk menaxhohen nga KRU Prishtina, Shalë, Krojmir, Resinovc

### 1.1. Ndotja e ujërave

Rrjedhja e ujërave të zeza në gjithë territorin e komunës është problem mjaft i madh, ku rreth 35% llogaritet se janë kyçur në rrjetin e kanalizimit ku derdhja e tyre rrjedh në lumenj dhe procka të pa trajtuara, ndërsa rrjetat e kanalizimit të ndërtuara pas luftës në disa fshatra, derdhja e tyre bëhet në ambient të hapur duke iu nënshtruar trajtimit nëpërmes gropave septike. Aktualisht nuk ka informacione të sakta sa i përket shkallës së kyçjes së familjeve private në rrjetin e grumbullimit të ujrave të zeza. Është vlerësuar se 50 deri 70% e popullsisë së qytetit të Lipjanit është i kyçur në sistemin e kanalizimit. Duke pasur parsysh pjesët rurale të komunës vlerësohet se vetëm një pjesë e vogël e popullsisë është e lidhur në rrjetin e sistemit të kanalizimit.

Objektet e banimit që nuk janë të kyçura në sistemin e kanalizimit i derdhin ujrat e zeza në lumenj apo prrocka të vogla, shfrytëzojnë gropa septike ose lejojnë që ujrat e zeza të derdhen në dhe/tokë. Pjesë të caktuara të rrjetit të kanalizimit janë në gjendje jo të mirë. Një pjesë e konsiderueshme e kanalizimeve mendohet se rrjedhin të pakontrolluara dhe shkaktojnë ndotjen e dheut dhe ujit tokësor.

Uji i shiut shkarkohet kryesisht në kanalizime. Drenazhe të ndara të ujrave të shiut ekzistojnë pjesërisht vetëm në qendrën e qytetit të Lipjanit. Stacionet e trajtimit të ujit kompatibile me standardet Evropiane nuk ekzistojnë ende. Megjithatë planifikohet të ndërtohen qendra për trajtimin e ujit në qytetin e Lipjanit dhe pjesët tjera të komunës. Duhet të konkludohet se sistemi I kanalizimit në Lipjan është qartë në nivel që duhet përmirësuar dukshëm. Niveli i ulët i grumbullimit të ujrave të zeza, rrjedhjeve në rjetin e kanalizimit dhe mungesa totale e qendrave për trajtimin e ujrave të zeza qon në kontaminimin organik të lumenjve dhe prrockave, dheut dhe ujrave nëntoksore. Ky kontaminim paraqet rrezik në shëndetin njerëzor pasi që furnizimi me ujë në komunë është ekskluzivisht i varur nga ujërat toksore. Për këtë arsye duhet të kemi parasysh edhe ndikimin në ndotjen e florës dhe faunës.

E njejta gjë vlen për sasinë e grumbullimit të ujrave të zeza në të ardhmen. Duke u bazuar në këto zhvillime në fushën e grumbullimit të ujrave të zeza, është më se e qartë se rrjeti i kanalizimeve duhet të zgjerohet dhe modernizohet. Për më shumë duhet të ndërtohen qendra të trajtimit të ujrave të zeza për t'i përballuar zhvillimet në të ardhmen.

Me zgjerimin e sistemit të kanalizimeve duhet të kemi një menaxhim më të përgjithshëm. Element thelbësor në menaxhimin modern të ujrave është grumbullimi ndaras i ujrave të shiut dhe ujrave të zeza. Përderisa ujrat e zeza duhet të grumbullohen dhe të trajtohen në sistem të mbyllur, kurse ujrat e shiut duhet trajtuar afër vendeve ku kemi qarkullim natyror të ujit. Kjo nënkupton mbajtje dhe kullim/filtrim të ujit të shiut në mënyrë që të mos kemi ndonjë vërshim, dhe ndihmon në koston e investimeve për infrastrukturë.

Shkarkimi i ujërave atmosferike bëhet në 3 pika shkarkuese pa trajtim paraprak në lumin Sitnicë, ndërsa një pikë kryesore për tërë qytetin e Lipjanit shkarkohet ne drejtim të livadheve te Sitnices.

Trajtimi i ujërave të ndotura – gjendja ekzistuese dhe forma e trajtimit të ujërave të ndotura është çështja më problematike, pasi që ka kosto të lartë të ndërtimit të impiantëve me standarde europiane. Në komunën e Lipajnit trajtimi i ujërave të ndotura bëhet vetëm me një trajtim primar përmes gropave septike, dhe pastaj shumica e atyre ujërave derdhen nëpër lumenj, të cilët grumbulohen në lumin Sitnicë. Për shkak të kostos së madhe për ndërtimin e impiantëve për trajtimin e ujërave të ndotura, komuna nuk ka mundur të bëjë ende zgjidhje, përjashtimisht për dy vendbanime, ku është duke u zgjidhur kjo çështje. Në fund të procesit të ndërtimit është impianti i trajtimit të ujërave të ndotura për venbanimet Vrellë dhe Medvec sipas standardeve të pranueshme teknike. Në funksion të kësaj komuna e Lipjanit ka hartuar një strategji për grumbullimin dhe trajtimin e ujërave të zeza në nivel komunal dhe mbi këtë strategji është duke i zbatuar projektet e sistemit të kanalizimeve.



Hidrologjia

## 2. Ajri dhe Zhurma

Ajri është një element mjaft i rëndësishëm për shëndetin e njeriut dhe në përgjithësi për mjedisin që na rrethon. Ajri është vazhdimisht nën ndikim të ndotjes nga shumë burime. Edhe pse ndotja e ajrit vjen kryesisht nga aktivitetet njerëzore, ai gjithashtu mund të ndikohet edhe nga fenomenet

natyrore. Ndotja e ajrit ndodh kur ajri përmban substanca në sasi që mund të dëmtojnë shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve ose mund të shkaktojnë dëme materiale.

Për cilësinë e ajrit në Komunën e Lipjanit nuk kemi ndonjë pajisje matëse për të vlerësuar tejkalimet e mundshme të parametrave të lejueshëm. Lidhur me këte shfrytëzohen të dhënat përkatëse nga komunat fqinje si Prishtina dhe Ferizaj, që sigurisht nuk paraqesin një pasqyrë reale për cilësinë e ajrit. Deri më tani komuna nuk ka arritur ndonjë zgjedhje përmes Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës

Si ndotës të ajrit në Komunën e Lipjanit konsiderohen: aktivitetet nga operatorët industrial për prodhimin e asfaltit, betonit, gjurthyesit, prodhuesit e gëlqerës, transporti, përdorimi i thëngjillit dhe drurit për ngrohje nga ekonomitë familjare, komerciale dhe institucionale etj.

Megjithëkëtë për të pasur një pasqyrë më të detajuar për burimet kryesore të ndotjes dhe ndikimin e tyre, komuna duhet të bëjë një hulumtim më të detajuar të ndotësve në ajër.
Bazuar në të gjeturat e këtij hulumtimi mundë të propozohen edhe masa konkrete për reduktimin e ndotjes së ajrit, sikurse janë aplikimi i teknologjive të pastra mjedisore, përdorimin e burimeve të ripërtrishtme të energjisë, ngritja dhe funksionalizimi i rrjetit për ngrohje qendrore në zonën urbane të qytetit, ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje, ndërtimi i objekteve industriale larg zonave të banuara urbane si dhe respektimi i ligjit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja.

Në kuadër të masave tjera për mbrojtjen e ajrit nga ndotja mund të përfshihen edhe shtimi i sipërfaqeve të gjelbëruara, pastrimi dhe mirëmbajtja e rregullte e rrugëve.
Një mundësi potenciale që ka Komuna e Lipjanit për të zvogëluar ndotjen përmes reduktimit të përdorimit të lëndëve djegëse në zonën urbane është edhe ndërtimi i sistemit te ngrohjes qendrore.

Trafiku rrugor dhe ai hekurudhor konsiderohen si burimet kryesore të zhurmës në Komunën e Lipjanit edhe pse aktualisht nuk ka ndonjë matje të organizuar të nivelit të zhurmës në komunë. Në mënyrë të veçantë këto burime të zhurmës intensifikohen gjatë zbatimit të aktiviteteve të ndryshme sikurse janë aktivitetet e ndërtimit, transporti i mallrave, gurëthyesit, përdorimi i pajisjeve industriale e tjera. Për asnjë nga këto burime të zhurmës nuk ka barriera që do të reduktonin nivelin e zhurmës dhe ndikimin e saj tek banorët e zonave ku shtrihen këto burime.

Komuna e Lipjanit duhet të ketë për bazë që zhurma është një nga ndotësit e mjedisit dhe matja e nivelit të saj është e nevojshme për të vlerësuar nivelin e ekspozimit të popullatës ndaj këtij ndotësi. Kjo është edhe kërkesë ligjore që del nga Ligjit për mbrojtje nga zhurma Nr. 02/L-102. Sipas këtyre kërkesave komuna obligohet të hartoj të Planin e Veprimit dhe Hartën e zhurmës, përmes së cilave do të identifikohen lokacionet që i ekspozohen zhurmës, prezantimi i tyre në hartë dhe propozimin e masave për parandalimin dhe zvogëlimin e ndotjes nga zhurma.

## 3. Toka dhe ndotja e saj

### 3.1. Faktorët me ndikim në degradimin dhe ndotjen e tokës

Natyra e Lipjanit është mjaft e shfryetëzueshme. Ajo ka shumë funksione, është shtëpi për shumë lloje të florës dhe faunës, ofron rekreacion për banorët lokal dhe tërheq turistët që kontribuojnë në ekonominë lokale. Mirëpo, degradimi i tokave bujqesore është si rezultat i ndërtimeve dhe planifikimit jo të mirë, infrastruktura jo adekuate, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga mungesa e trajtimit të ujërave, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi i plehrave urbane, si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesa e riciklimit etj.

Një ndër çështjet me rëndësi në fushën e mbrojtës të mjedisit është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Degradimi i pyjeve po ndikon në shkatërrimin e sipërfaqeve, të cilat e kanë edhe rolin e mbrojtësit, nga erozioni. Uji i shkaktuar nga të reshurat e mëdha po kalon pa ndonjë pengesë në shtretërit e

lumenjve, që si rezultat sjellin vërshimet. Rrezik tjetër permanent paraqesin edhe të reshurat, të cilat ndikojnë në rritjen e sasisë dhe nivelit të ujit në lumenj, të cilët të pambrojtur vërshojnë sipërfaqe të mëdha të tokës kualitative bujqësore. Perdorimi I pakontrolluar i pesticideve të ndryshme për trajtimin e barojave te kqija etj.

### 3.2. Tokat erozive

Gjatë periudhave kur të reshurat janë të shpeshta dhe pas shkrirjes së borës, sasia e ujit rritet duke krijuar përmbytje (vërshime). Faktorë të tjerë që shkaktojnë vërshime, janë edhe mbeturinat nëpër lumenj, si dhe rrokullisjet e gurëve nga bjeshkët.

Zonat e rrezikuara nga vërshimet janë zonat pranë rrjedhave dhe kjo si rezultat i mungesës së pandave mbrojtëse Komuna duhet të krijojë bazën e të dhënave për rrjedhat e lumenjve dhe erozioneve dhe ti vendosë ato në GIS harta për të treguar zonat ku vërshimet mund të ndodhin. Këto të dhëna do të shërbejnë për mbikqyerje të vazhdueshme të lumenjve dhe për analiza hapësinore për nivelin e ndikimeve nga vërshimet. Komuna në bashkëpunim me institucionet përkatëse të nivelit qendror duhet të hartojë planin e veprimeve nga vërshimet dhe masat zbutëse për përgjigje të menjëhershme ndaj rreziqeve nga vërshimet.

### 3.3. Erozioni

Erozioni është njëri nga faktorët mjaftë të rëndësishëm për ta trajtuar nga se rrezikon sipërfaqet bujqësore, infrastrukturën, por edhe të mirat e krijuara dhe të planifikuara nga faktori njeri. Kjo dukuri është prezente pothuaj në tërë territorin e komunës së Lipjanit në forma dhe madhësi të ndryshme. Përshpejtimin e kësaj dukurie në shumë raste e ka luajtur edhe faktori njeri si rezultat i mos shfrytëzimit racional të tokave bujqësore, prerjes së pa kontrolluar të pyjeve, por edhe gjatë shfrytëzimit të pa kontrolluar të materialeve inerte dhe ndërtimore. Më tepër prezent është mbi formacionet molasike si rezultat i degradimit të pyjeve, vegjetacionit dhe pjerrësisë së terrenit, i cili paraqitet në formë të shpëlarjeve sipërfaqësore dhe lugjeve rrëke, por edhe përgjatë brigjeve të shtretërve të lumenjve, e përrenjve, përdorimit të pa përshtatshëm të tokës, mos ndërtimi i pritave malore etj.



Erozioni

### 3.4. Shkalla e erozionit

Territori i komunës së Lipjanit karakterizohet me një pjesëmarrje të sipërfaqeve erozive sipas këtyre kategorive: Sipërfaqet të cilat i janë nënshtruar erozionit shumë të dobët 30% erozionit të dobët përfshijnë sipërfaqen rreth rreth 30% të territorit. Erozioni i mesëm 27%. Hapësirat me erozion të fortë në komunën e Lipjanit përfshijnë 9 %. Erozioni shumë i fortë 2 %.




## 4. Menaxhimi i mbeturinave

Menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Lipjanit e bënë KRM "PASTRIMI: NJ.O. LIPJAN. Kjo kompani kryen shërbime në qytetin e Lipjanit dhe fshatrave të Komunës së Lipjanit, përkatësisht në 57 fshatra. Në sistem për menaxhimin e mbeturinave janë përfshirë 8839 ekonomi familjare nga gjithsejë 9497 sa janë në Komunën tonë, ku mbulueshmëria e tyre është rreth 90 %. Kjo kompani ofron shërbime edhe për biznese qe operojnë në Komunën e Lipjanit.
Shërbimet ofrohen për 1895 biznese te ndryshme nga 3076 sa janë te regjistruara apo afer 70% të tyre dhe për afër 85% të instuticioneve publike.
Menaxhimi i mbeturinave ne Komunen e Lipjanit është një ndër sfidat më të mëdha ku si faktor me ndikim konsiderohen:
- Pagesat e uleta mekanizmi i vjetersuar numri i vogel i punëtorëve etj.
- Ridizajnimi i pikave të përgjithshme të vendosjes së kontenjerëve konform numrit të banorve.
- Funksionalizimi dhe menaxhimi i lokacionit për grumbullimin e mbetjeve inerte.
- Vënia nën kontroll e të gjithave mbetjeve shtazore.
- Mungesa e kontenjereve 1.1m në disa pika të nevojshme brenda qytetit.
- Nevoja për rritjen e numrit te automjeteve në shërbim të bartjes së mbeturinave.
- Format e reja të mënyres së riciklimit te mbeturinave.

Shkalla e inkasimit ne vitin 2021

| | |
|---|---|
| Amvisëritë | 417,927.25 |
| Bizneset | 42,050.72 |
| Institucionet | 218.76 |

Deponimi i mbeturinave ne vitin 2021

| Sasia e mbeturinave | 10053.12 TON. |
| --- | --- |

Ne qytetin e Lipjanit shërbimi zhvillohet 7 ditë në javë nga ora 19 në mbremje.
Në pjeset nderurbane dhe fshatra shërbimi kryhet derë më derë një herë në javë.
Mbulueshmeria me sherbim ne qytet është 80%/
Mbulueshmeria në fshatra është 90%.
Numri i punëtorve është 58 qe konsiderohet jo i mjaftueshem duke pas parasysh rritjen e numrit te ekonomive familjare ne sistem.

Mekanizimi: gjithsej 7 kamion te kapacitetit 1.1M, nje kamion te kapacitetit 7, nje Auto fshisë, Kamion te Bores, Eskavator - ngarkues, Autoveture dhe Kamion transportues.

Me qëllim të rritjes së shërbimeve planifikohet detyrimi i lidhjes së kontratave me disa biznese të caktura të cilat kanë shfrytëzuar shërbimin por i janë shmangur obligimeve ndaj ndërmarrjes. Kerkohet një bashkpunim në rritje me institucionet komunale me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve.

Zgjerimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave të bëhet në tër komunën. Mbyllja dhe mbulimi i vendhudhjeve ekzistuese në përputhje me standarded përkatëse. Planifikimi i vend-hudhjes së re të mbeturinave duhet të jetë komplementare me krijimin e hapsirave të seleksionimit edhe për (hapësira për trajtimin termal dhe biologjik) të mbeturinave. Zvogëlimi i sasisë se reciklimit të mbeturinave, gjegjësisht të bëhet promovimi i çasjeve ekonomike. Të bëhet pastrimi i vend-hudhjeve ilegale të mbeturinave sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që komuna e Lipjanit të ofrojë një ambient atraktiv për investitorët dhe qytetarët.
Rekomandohet një program i menjëhershëm për mbledhjen e mbeturinave të hudhura ilegalisht.

## 5. Biodiversiteti

Komuna e Lipjanit ka një shtrirje mjaft të madhe gjeografike e cila përfshin zonat mesatarisht të larta dhe zonat e ulëta të terrenit. Në këtë komunë sa i përket fitodiversitetit i lidhur me llojet e bimëve drunore shkon deri te brezi i ahishteve (Fagus silvatica) të përziera me bung (Quercus petraea), ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqrime mjaft të mëdha dhe të begatshme me lloje. Po ashut në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve dhe vendbanimeve por edhe barojat e këqia të cilat gjenden në tokat djerrina, në kufi të parcelave dhe në afërsi të gjerdheve.

Sa i përket Zoodiversitetit kjo komunë me fshatrat që e rrethojnë ketë komunë janë të pasura me llojllojshmëri shtazore, këtu vlenë të përmendet Parku Natyror Blinaja. Prezenca e shumë shtazëve të egra, si dreri, kaprolli, derri i egër, muflloni, macja e egër, lepuri, ujku, dhelpëra etj., si dhe shumë shpezë, e bëjnë këtë vend atraktiv. Vet kushtet natyrore në Blinajë mundësojnë një regjenerim të botës bimore dhe shtazore mjaft të përshtatshme për rekreacion dhe vizitorë. Sa i përketë zoodiversiteti, sipas të dhënave, dhe analizave të ekipit punues territori i komunës së Lipjanit është i pasur me kafshë të egra edhe në zona të tjera në mesin e të cilave ka edhe lloje që konsiderohen si të rrezikuara dhe në këtë drejtim, parashikohet mbrojtja e zonave ku jetojnë dhe veprojnë këto kafshë, dhe bimë si dhe mbrojtja e tyre si specie.

Pas hulumtimeve të bëra në fitodiversitetin e komunës së Lipjanit, parashikohet që disa lloje të mbrohen, ruhen dhe konservohen pasi që është konstatuar se ekzistojnë fitocenoza të cilat janë mjaft të begatshme dhe interesante në aspektin ekonomik, shkencor dhe mjekësor.

Në fushën e biodiversitetit, parashihen projekte të përbashkëta me komunat tjera. Parashihet inventarizimi i florës dhe faunës në gjithë territorin e komunës, duke specifikuar çka duhet të mbrohet dhe çka mundë të shfrytëzohet.
Parashikohet një rezervat për ruajtjen e kaprrollit (Capreolus capreolus), ujkut (Canis lupus), dhelprës (Vulpes vulpes), arealet e të cilave janë mjaft të rrezikuar.
Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore, në territorin e komunës së Lipjanit. Duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj.

Në komunën e Lipjanit deri më tani janë vënë nën mbrojtje disa zona me rëndësi të veçantë.
**Monumenti i Natyrës me Rëndësi të Veçantë "Shpella e Gadimes"** - ndodhet në fshatin Gadime e Ulët të Komunës së Lipjanit, e lokalizuar në kodre e "Mërturit", ndërsa hyrja ndodhet në pjesën e poshtme të grykës së lumit (përroskës) Klysura në lartësi mbidetare 580 metra. Për shkak të vlerave të mëdha, kristaleve, dukurive shpellore interesante dhe pozitës së përshtatshme shpella përgatitet dhe hapet për vizitor në vitin 1976.

**Vend Gjuetia e Rëndësisë së Veçantë "BLINAJA"**- Shtrihet në tri Komuna, atë të Lipjanit, Drenasit dhe Shtimes dhe ka një sipërfaqe prej 2795/ha, dhe është e tipit të mbyllur. Karakterizohet me zoodiversitet të pasur. Kjo njësi menaxhimi shtrihet në pjesën perëndimore të ultësirës së Kosovës, në jugperëndim të Prishtinës në largësi prej 32 km dhe ngrihet në lartësitë 600 - 850 m mbi nivelin e detit, në një rajon kodrinor. Sipas destinimit, është zonë gjuetie me rëndësi të veçantë, e themeluar në vitin 1955 dhe rithemeluar në shkurt të vitit 2009.

**Ligatina e Hencit-Radevës e lokalizuar ndërmjet komunave F. Kosovë, Graçanicë dhe Lipjan,** me një sipërfaqe prej 109 ha. Është zonë me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrologjike, botanike dhe peisazhore.

**Monumenti i Natyrës "Burimet e Ujit" në fshatin Baicë**- monument i natyrës me karakter hidrologjik me një sipërfaqe prej 5 ari. Gjithashtu janë vënë nën mbrojtje një numër i madhë i Monumenteve të Natyrës me karakter botanik si: "Trungu i Qarrit (Querqus cerris)" në fshatin Gadime e Epërme; Trungu i Bungbutës (Quercus pubescens)" në fshatin Dobrajë e Madhe, dhe kështu një mori vlera tjera botanike nëpër lokalitete të ndryshme të komunës së Lipjanit janë vënë nën mbrojtje sipa dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës.

**Flora** – Fitodiversitetit në komunën e Lipjanit shkon deri te brezi i ahishteve (Fagus silvatica) të përziera me bungë (Quercus petraea), ndërkaq në zonat e ulëta kemi vegjetacionin e livadheve me shoqrime mjaft të mdha dhe të begatshme me lloje. Po ashtu në këto zona e gjejmë edhe vegjetacionin ruderal përgjat rrugëve, vendbanimeve, dhe në tokat djerrina.

**Fauna-** Komuna e Lipjanit karakterizohet me një zoodiversitet të pasur. Për rëndësinë e biodiversitetit shquhet Vend Gjuetia e Rëndësisë së Veçantë "Blinaja", me një llojllojshmëri të madhe të faunës. Ky rezervat shtrihet në një sipërfaqe prej 2795ha. Llojet kryesore të faunës së egër në Blinajë janë: Derri i egër (Sus scrofa) - me rreth 500 krerë, Dreri i kuq (Cervus elaphus) - rreth 150 krerë, Dreri i murrmë (Dama dama) - rreth 100 krerë, Kaprolli (Capreolus capreolus) - rreth 170 krerë. Lloje tjera prezentë janë edhe Vjedulla (Meles meles), Shqarthi i ahut (Martes sp.), Shqarthi i pishës evropiane (Martes sp.), Lepuri (Lepus europeus), Korbi (Corvus corax), Laraska (Pica pica), Shqiponja minj ngrënëse (Buteo buteo), Rosa e egër (Anas querquerdula), Macja e egër (Felis sylvestris), Ketri (Sciurus vulgaris), etj.

Parashikohet revitalizimi i ekosistemeve pyjore për parandalimin e shkatërrimit të habitateve të shumë llojeve bimore dhe shtazore, në territorin e komunës së Lipjanit. Duke e konsideruar të rëndësishme edhe ruajtjen e habitateve të fluturave, shpezëve mishngrënës etj.

Problemet me të cilat ballafaqohet mjedisi në komunën e Lipjanit, i atribuohen kryesisht mosmenaxhimit të duhur të ujërave të zeza dhe mbetjeve të ngurta, të cilat ndotin tokën dhe ujërat. Në anën tjetër aktivitetet në bujqësi, gurëthyesit, degradimi i pyjeve, ndërtimet në tokat bujqësore, veprimtaritë e caktuara biznesore, komunikacioni dhe aktivitete tjera janë një kontribues i madhë i ndotjes mjedisore.

### 5.1. Gjendja e pyjeve

Përkundër parimeve mbi menaxhimin, ruajtjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirë parimin parandalues, konservimin e diversitetit biologjik, barazisë ndërbreznore dhe zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, gjendja e pyjeve dita ditës po ndryshon. Ndryshimet në gjendjen e pyjeve janë kryesisht në zvogëlimin e fondit pyjor, llojit të drunjtëve, si dhe sipërfaqeve të pyllëzuara nga prerjet ilegale dhe zjarret.

### 5.2. Roli prodhues

Roli prodhues i pyjeve të Lipjanit është mjaft i rëndësishëm, duke iu falënderuar strukturës së sipërfaqeve pyjore. Mirëpo, prodhimi i tanishëm i pyjeve të territorit të Lipjanit është zvogëluar dukshëm nga prerjet e egra të paraluftës dhe ato ilegale që janë mjaft të larta edhe sot.

Funksioni më i rëndësishëm i pyjeve është se ato mbrojnë tokën nga erozioni dhe mënyrat e ndryshme të zhveshjes dhe kanë ndikim në karakteristikat klimatike, në pengimin e vërshimeve të sipërfaqeve bujqësore dhe vendbanimeve në pjesët pranë bregut të ujërave.

Në Komunë e Lipjanit nuk ka pyje për destinim të veçantë, ato kryesisht kanë karakter ekonomik dhe pjesërisht mbrojtës nga erozioni dhe ndikimet e ndryshme natyrore, ndërsa zona të shpallura nën mbrojtje është Rezervati Blinaja.

### 5.3. Faktoret me ndikim në degradimin dhe ndotjen e tokes

Natyra e Lipjanit është shume e vlefshme. Ajo ka shumë funksione, është shtëpi për shumë lloje të florës dhe faunës, ofron rekreacion për banorët lokal dhe tërheq turistët që kontribuojnë në ekonominë lokale. Mirëpo, degradimi I tokave bujqesore është si rezultat i ndërtimeve pa leje dhe planifikimit jo të mirë, infrastruktura jo adekuate, ndotja e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, nga mungesa e trajtimit të ujërave, prerja e pakontrolluar e pyjeve, akumulimi I plehrave urbane, si pasojë e mos menaxhimit të mirë, mungesa e riciklimit etj.

Një ndër çështjet me rëndësi në fushën e mbrojtës të mjedisit është prerja e pakontrolluar e pyjeve. Degradimi i pyjeve po ndikon në shkatërrimin e sipërfaqeve, të cilat e kanë edhe rolin e mbrojtësit, nëpër të cilat uji i shkaktuar nga të reshurat e mëdha po kalon pa ndonjë pengesë në shtretërit e lumenjve, që si rezultat kemi vërshimet. Rrezik tjetër permanent paraqesin edhe të reshurat, të cilat ndikojnë në rritjen e sasisë dhe nivelit të ujit në lumenj, të cilët të pambrojtur vërshojnë sipërfaqe të mëdha të tokës kualitative bujqësore. Perdorimi i pakontrolluar i pesticideve të ndryshme per trajtimin e barojave te demshme etj.

## V. PROBLEMET KRYESORE MJEDISORE

| 1. Përshkrimi i problemeve kryesore mjedisore sipas sektoreve |
|---|
| **Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre** |
| • Ndotja e ujërave sipërfaqësore nga shkarkimi i ujërave të zeza dhe atyre industriale në lumenjë pa trajtim paraprak; |

- Ndotja i shtretërve të lumenjëve nga mbeturinat komunale, mbeturinat industriale dhe aktivitetet tjera njerëzore;
- Sasi e pamjaftueshme e ujit sipërfaqësor dhe nëntokësor për pije dhe për nevoja tjera;
- Cilësi e dobët e ujërave sipërfaqësore në rrjedhën kryesore të lumit;
- Qasja në rrjetin e ujësjellësit dhe në rrjetin e kanalizimit ende nuk është ofruar për të gjitha ekonomite familjare;

**Ajri dhe zhurma**

- Tejkalime të vlerave të lejuara të cilësisë së ajrit në zonën urbane të komunës;
- Shkarkime të dëmshme në ajër nga proceset industriale, ngrohja në ekonomitë familjare, bizneset dhe transporti.
- Nuk ka Plan Lokal té Veprimit për Cilësi të Ajrit;
  Ndotja nga zhurma që vjen kryesisht nga industria dhe transporti;
- Mungon Plani Lokal për Mbrojtje nga Zhurma

**Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut**

- Humbja e tokës me cilësi të lartë bujqësore nga zgjerimi i vendbanimeve dhe aktivitetet ekonomike;
  - Ndotja e tokës nga deponitë e mbeturinave komunale, mbeturinave industriale dhe nga aktivitetet tjera ekonomike;
- Fragmentimi i parcelave dhe tokave bujqësore dhe ndërrimi i destinacionit të tokave bujqësore;
- Degradimi i tokës nga aktivitetet e shfrutezimit të resurseve minerare dhe erozioni;
- Mungesa e planeve lokale për mbrojtje të tokës;

**Menaxhimi i mbeturinave**

- Menaxhim i mbeturinave komunale në hapësira publike ka nevojë për fuqizim të mëtejmë;
- Deponi ilegale të mbeturinave në disa zona të komunës;
- Ndarja reciklimi, kompostimi dhe format tjera të trajtimit të mbeturinave janë në shkallë shumë të ulët;.
- Kapacitete të limituara teknike për ndarjen dhe trajtimin e mbeturinave;

**Natyra dhe biodiversiteti**

Në territorin e komunës ka zona/monumente të mbrojtur të natyrës;

- Mbrojtje jo e mjaftueshme e peisazhit natyror dhe ekosistemeve;
- Degradimi i habitateve natyrore dhe peisazhit, degradimi i pyjeve nga prerjet ilegale;
- Mungesa e Programit Lokal për Mbrojtjen e Biodivesitetit;
- Mungese e planeve lokale për zhvillimin e turizmit dhe promovimin e tij.

**KONKLUZIONE**

- Niveli jo i kënaqshmë i vetëdijes mjedisore;
- Pjesëmarrje e ulët e publikut në vendimmarrjen mjedisore;

- Zbatim i pamjaftueshëm i VSM-së dhe VNM-së për planet, programet dhe projektet e nivelit lokal;
- Numri i vogël i inspektorëve për sektorin e mjedisit.
- Buxheti i limituar në sektorin e mbrojtjes së mjedisit.

## 2. Prioritetet mjedisore për periudhën 2023-2027

### Resurset ujore dhe menaxhimi i tyre

- Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore nga ndotja urbane dhe industriale;
- Zbatimi i vendimeve për zonat e mbrojtura ujore sipas Vendimeve të Qeverisë:
  - Tete (8) puse te ish fabrika e Letres ( parcellat jane ne prone private) Vendimi per mbrojtjen e zonave I II, dhe III;
  - Gjashte (6) puse te arat e konjuhit( parcellat pjeserisht jane prone e Komunes) eshte ne proces Vendimi per zonat mbrojtese I, II, III
- Mbrojtja e resurseve ekzistuese të ujrave:

Përmirësimi i mbrojtjes së burimeve ujore në sistemet rurale të ujërave.
KRU "Prishtina" sh.a Njesia Operative e Ujësjellësit në Lipjan ka afër 12000 konsumatorë të cilët furnizoheh nga këto burime nëntokësore në akuifer intergranular.

Lokacionet e pueseve nëntokesore të cilët furnizohen qytetaret e Komunes së Lipjanit:
- Tetë (8) puse të ish fabrika e Letres (parcellat janë në pronë private) ekziston vendimi per mbrojtjen e zonave I, II, III;
- Tetë (8) puse te livadhet afer ETC (parcella eshte prone e AKP);
- Gjashte (6) puse te arat e Konjuhit (parcellat pjesërisht janë pronë e Komunës) eshte ne proces vendimi per zonat mbrojtese I, II, III;
- Një (1) pus në Vrellë (parcela është pronë e Minieres së Magnezitit në Magure);
- Katër (4) puse në Marec (parcelat janë ne pronë private);
- Pesë (5) puse grumbulluese në Sllovi (parcellat janë në pronë private);
- Tri (3) puse në Qylagë që nuk janë të shfrytëzueshëm (parcella është pronë e Komunës);
- Burimet e ujit që nuk menaxhohen nga KRU Prishtina, gjenden në Shalë, Krojmir dhe Resinovc.

- Rritja e kapaciteteve për trajtimin e ujërave të ndotura urbane dhe industriale;
- Rritja e kapaciteteve për furnizim me ujë tê pijes dhe mbulueshmërisë më shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimit;
- Mbrojtja nga vërshimet dhe përmbytjet;
  - Identifikimi i pikave të rrezikshme për vërshime;
  - Hartimi i projekteve konkrete për parandalimin e përmbytjeve.

### Ajri dhe zhurma

- Plotësimi i bazës rregullative, programore dhe institucionale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja dhe menaxhimin e ajrit;
- Përmirësimi i cilësisë së ajrit përmes zbatimit të masave për reduktimin e shkarkimeve në ajër;
- Përmirësimi i informimit dhe rritja e vetëdijësimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit;

- Reduktimi i zhurmës përmes zbatimit të masave dhe hartimit të planeve përkatëse;

**Shfrytëzimi i tokës dhe cilësia e dheut**

- Mbrojtja e tokës bujqësore nga ndërtimi, aktivitetet ekonomike dhe ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo-direkte;
- Mbrojtja e tokës nga erozioni dhe përmbytjet;
- Përmirësimi i tokave të degraduara;
- Rehabilitimi dhe restaurimi i tokave tê ndotura;

**Menaxhimi i mbeturinave**

- Përmirësimi i sistemit për grumbulimin e mbeturinave dhe rritja e mbulushmërisë me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave;

- Në kuader të Planit lokal për menaxhimin e mbeturinave të trajtohen:
  Menaxhimi i mbeturinave voluminoze, elektrike/elektronike, vajrave të përdorura:
  - Caktimi i pikave për grumbullimin e këtyre rrymave;
  - Hapja pranë këtyre pikave të dyqaneve të dorës së dytë ;
  - Stimulimi i bizneseve dhe lidhja e marrëveshjeve me to për grumbullimin e rrymave të veçanta siç mund të jenë (bateritë, vajrat e përdorura, makinat në fund të jetës së tyre);
  - Mundësia e asgjësimit të mbetjeve shtazore në nivel rajonal/furnizimi i prodhuesve me kontenierë të veçantë dhe përcaktimi i masave për transportin dhe asgjesimin e kësaj rryme;
  - Hartimi i rregulloreve të veçanta për menaxhimin e çdo rryme (roli detyrat përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit).

- Manaxhimi i mbeturinave spitalore:
  - Përcaktimi i sasive të prodhuara të mbeturinave të rrezikshme spitalore;
  - Caktimi i protokolleve për grumbullimin, magazinimin dhe transportin e sigurt të tyre;
  - Furnizimi me infrastrukturën e nevojshme për grumbullimin e diferencuar të kësaj rryme
  - Identifikimi i mundësisë për asgjësimin në nivel rajonal.

- Manaxhimi i mbeturinave inerte (Prioritet):
  - Formulimi dhe publikimi i një fushate vetëdijësimi për mbeturinat inerte;
  - Zbatimi i legjislacionit dhe përgjegjësisë së zgjeruar të prodhuesit;
  - Vendosja e protokolleve të veçanta për grumbullimin dhe transportin për gjeneruesit e mbetuinave inerte;
  - Hartimi i një rregulloreje të veçantë për këtë rrymë (roli detyrat përgjegjësitë, protokollet e grumbullimit, transportit dhe asgjësimit)
  - Funksionalizimi i lokacionit/deponisë për mbetje inerte.

- Eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave komunale dhe industriale;
  - Mbledhja, ngarkimi, transportimi dhe deponimi i mbeturinave siperfaqësore të llojeve të ndryshme, në pika të ndryshme në tërë teritorin e Komunës së Lipjanit;
  - Pastrimi i vendit nga i cili janë larguar mbeturinat dhe nivelizimi i terenit. Gjatë nivelizimit duhet të mbulohet me dhe sipërfaqja në mënyrë që të rregullohet dhe të përgatitet për shfrytëzim normal të tij;
  - Nga kompania KRM "Pastrimi" të bëhet largimi i vazhdueshëm i deponive, duke edukuar komunitetin për të mos hedhur mbeturinat në këto zona;
  - Fillimi i një fushate vetëdijësimi, duke vendosur mbishkrime si "Ndalohet hudhja e mbeturinave", si dhe takime me banorët që jetojnë afër deponive ilegale.

- Parandalimi i krijimit të deponive:
  - Sigurimi i deponive duke i rrethuar me gardh pas pastrimit të tyre, për të evituar rikrijimin e tyre;
  - Pas pastrimit të tyre dhe rrethimit me gardh, komuna mund të vendos që këto zona t'i kthejë në zona rekreative, si gjelbërimi i tyre duke i mbjellë me barë;

- Vendosja e disa tabelave informuese pranë zonave të deponive të egra "Mos hudhni mbeturina" apo "Ndalohet hudhja e mbeturinave";
- Monitorimi i vazhdueshëm i pikave të nxehta, duke shtuar aktivitetin e inspektorëve në këto zona. Raportime të rregullta mujore në lidhje me gjendjen e deponive të egra, duke angazhuar edhe komunitetin për të evidentuar dhe raportuar raste të depozitimeve ilegale;
- Njoftimi i komunitetit që në rast se ata identifikohen që kanë deponuar mbeturina në atë zonë, do të merren masa ndëshkuese.

- Rritja e kapaciteteve dhe mundësive për ndarjen, riciklimin dhe kompostimin e mbeturinave;
- Hartimi i një sistemi monitorimi për matjen e performancës të shërbimit, organizimi i fushatave të vetëdijësimit për mbeturina.

**Natyra dhe Biodiversiteti**

- Identifikimi dhe studimi i zonave të natyrës që plotësojnë kriteret për tu shpallur zona të mbrojtura;
- Hartimi i Planit për menaxhimin e trashegimisë natyrore;
- Promovimi i vlerave natyrore dhe zhvillimi i turizmit malor;
- Parandalimi i veprimeve që dëmtojnë natyrën, biodiversitetin dhe pyjet;
- Ripyllëzimi i zonave të shpyllëzuara;

**KONKLUZIONE**

- Niveli jo i kënaqshëm i vetëdijes mjedisore;
- Pjesëmarrje e ulët e publikut në vendimmarrjen mjedisore;
- Zbatim i pamjaftueshëm i VSM-së dhe VNM-së për planet, programet dhe projektet zhvillimore të nivelit lokal;
- Numri i vogël i inspektorëve për sektorin e mjedisit;
- Buxheti i limituar në sektorin e mbrojtjes së mjedisit;
- Parandalimi i ndikimeve negative në mjedis që vijnë nga zbatimi i projekteve dhe planeve sektoriale.

## 3. PLANI I AKTIVITETEVE

| Ob. | Prioritet | Aktivitetet | 2023 | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Resurset ujore dhe menaxhimi I tyre | Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore Rritja e cilësisë dhe sasisë së ujit të pijes | Përgaditja e studimit të fizibilitetetit për ndërtimin e impiantit për trajtim të ujërave të zeza për Komunën e Lipjanit. | | x | | | |
| | | Përgaditja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e impianteve për kapacitete të vogla për ato pjesë që nuk përfshihen në impianitin kryesor për trajtimin e ujërave te zeza. | | | x | | |
| | | Pastrimi i deponive të mbeturinave në brigjet e lumenjeve dhe rrjedhat tjera ujore. | x | x | x | | |
| | | Zbatimi i UA për normat e shkarkimeve të ujërave të ndotura nga operatorët ekonomik. | x | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Përgatitja e projektit për trajtimin e zonave të mbrojtura sanitare në Lipjan dhe zonat tjera të përcaktuara në HZK. | x | x | | | |
| | | Rritja e kapacitetit për furnizim me ujë të pijes për vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit. | x | x | | | |
| | | Ndërtimi i kolektorëve anësor të ujërave të zeza përgjatë rrjedhave ujore. | | x | x | | |
| | Mbrojtja nga vërshimet dhe përmbytjet | Finalizimi i projektit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtratit të lumenjeve. | x | x | | | |
| | | Ngritja e vetëdijes së qytetareve për rastet e përmbytjeve. | x | | | | |
| Ajri dhe zhurma | Plotësimi i bazës rregullative, programore dhe institucionale per menaxhimin e ndotjes së ajrit | Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit. | 2023 | x | | | |
| | | Hartimi i Rregullores për menaxhimin e cilësisë së ajrit | 2023 | x | | | |
| | | Hartimi i Planit Lokal të Mobilitetit. | | x | | | |
| | Përmirësimi i cilësisë së ajrit | Identifikimi i burimeve të ndotjes së ajrit përmes hulumtimit të burimeve të emisioneve në ajër. | x | | | | |
| | | Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonën urbane dhe përrreth zonave komerciale dhe industriale. | | x | | | |
| | | Ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje në zonën urbane. | | | | x | |
| | | Përgaditja e projektit për ndërtimin e infrastrukturës për ngrohje qendrore. | | x | | | |
| | Përmirësimi i informimit dhe rritja e vetëdijësimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit | Sensibilizimi i opinionit lidhur me përfitimet që krijohen me aplikimin e masave efiçiente në objektet e banimit. | x | | | | |
| | | Blerja e stacionit mobil për monitorimin e cilësisë së ajrit në territorin e Komunës së Lipjanit | x | | | | |
| | | Vendosja e TV ekraneve që tregojnë nivelin e ndotjes në lokacione të ndryshme në qytet. | x | | | | |
| | | Nxitja dhe mbështetja teknike e ekonomive familjare për renovimin e objekteve dhe përmirësimin e izolimit termik. | | x | | | |
| | Reduktimi i zhurmës | Hartimi i Planit Lokal për Reduktimin e Zhurmës. | | | x | | |
| | | Vendosja e barrierave për reduktimin e zhurmrës përrreth objekteve që shkaktojnë zhurmë/autoudha, zonat komerciale indsutriale. | | | x | | |
| | | Reduktimi i qarkullimit të automjeteve të rënda në zonën urbane (Caktimi i rrugëve për kalimin e mjeteve transportuese me peshë mbi 7.5t) | | | x | | |
| | | Zbatimi i orarit për limitetet e tejkalimit të normave të zhurmës në zonat urbane /HZK. | x | | | | |
| Shfry | Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë | Fushatë vetëdijësimi dhe informimi për mbrojtjen e tokës bujqësore. | x | | | | |
| | | Mbikëqyrje e ndërtimeve në tokën | x | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | nga ndërtim | bujqësore sipas kritereve të HZK. | | | | | |
| | | Hartimi i Planit të zhvillimit rural. | | x | | | |
| | Mbrojtja e tokës nga erozioni dhe përmrësimi i tokave të degraduara | Identifikimi i tokave të ndikuara nga erozioni. | x | | | | |
| | | Pyllëzimi i sipërfaqeve të tokës të ndikuara nga erozioni. | | x | | | |
| | | Aplikimi i subvencioneve dhe stimulimeve për farmerët që punojnë tokat djerrina. | x | | | | |
| | Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo - direkt | Pastrimi i tokave bujqësore nga deponitë e mbeturinave komunale. | x | | | | |
| | | Pastrimi i tokave bujqësore nga deponitë e mbetjeve të makinave. | x | | | | |
| | | Ndalimi i derdhjes së ujërave urbane në toka bujqësore | x | | | | |
| | | Fushata vetëdijësimi me farmerë/e për përdorimin e drejtë të plehrave kimike dhe përmirësimin e cilësisë së tokës. | x | | | | |
| Menaxhimi i mbeturinave | Përmirësimi i sistemit për grumbulimin e mbeturinave | Rritja e numrit të ekonomive familjare në sistemin e grumbullimit të mbeturinave. | x | | | | |
| | | Shtimi i kapaciteteve teknike të NP "Pastrimi" për grumbullimin e mbeturinave. | | x | | | |
| | | Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave komunale dhe deponive të mbeturinave nga makinat e vjetra. | x | | | | |
| | | Aplikimi i gjobave për personat fizik dhe juridik që hedhin mbeturina në vendet jo adekuate. | x | | | | |
| Natyra dhe biodiversiteti | Rritja e nivelit dhe mundësive për reciklimin dhe kompostimin e mbeturinave | Shtimi i kapaciteteve teknike për ndarjen e mbeturinave në vendburim. | | x | | | |
| | | Fushatë vetëdijësimi për reciklimin e mbeturinave komunale. | x | | | | |
| | | Shpërndarja e komposterëve familjarë për komopostimin e mbeturinave organike. | x | | | | |
| | Rritja e numrit të zonave të mbrojtura dhe promovimi i vlerave të tyre natyrore | Hartimi i planit lokal të veprimit për biodiversitetin. | | x | | | |
| | | Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës. | | x | | | |
| | | Shenjëzimi i zonave të mbrojtura të natyrës. | x | | | | |
| | | Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit. | x | | | | |
| | Parandalimi i veprimeve që e dëmtojnë natyrën, biodiversitetin dhe pyjet | Implementimi i masave për parandalimin e zjarreve në male. | x | | | | |
| | | Kontrollimi i gjuetisë ilegale. | x | | | | |
| | | Mbrojtja e pyjeve nga degradimi dhe prerjet ilegale | xx | | | | |
| | Parandalimi i efekteve mjedisore nga zhvillimet e reja | Zbatimi efikas i VNM në projektet e nivelit lokal. | | | | | |
| | | Integrimi i VSM-së në kuadër të planeve, programeve në nivelin lokal. | x | | | | |
| | Ngritja e | Organizimi i fushatave vetëdijesuese për | x | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore | mbrojtjen e mjedisit në shkollat fillore. | | | | | |
| | | Bashkëpunimi me OJQ dhe Shoqërinë Civile për procesin e vendimmarrjes mjedisore. | | | | | |
| | | Nxitja e Partneritetit Publiko Privat (PPP) ose Pjesëmarrjen e Sektorit Privat (PSP) në menaxhimin e mbeturinave. | x | x | x | | |
| | Fuqizimi i inspektoratit mjedisor | Shtimi i numrit të inspektorëve për sektorin e mjedisit dhe mbeturinave. | x | | | | |
| | | Përmirësimi i kushteve të punës për inspektorët dhe zbatimi i stimulimeve. | x | | | | |

## 4. Plani i monitorimit

| Ob. | Prioriteti | Aktivitetet | Indikatori | Rezultatet e pritura |
|---|---|---|---|---|
| Resurset ujore dhe menaxhimi I tyre | Mbrojtja e cilësisë së ujërave sipërfaqësore<br><br>Rritja e cilësisë dhe sasisë së ujit të pijes | Përgatitja e studimit të fizibilitetetit për ndertimin e impiantit për trajtim të ujërave të zeza për Komunën e Lipjanit<br>Përgaditja e studimit të fizibilitetit për ndërtimin e impianteve për kapacitete të vogla për ato pjesë që nuk përfshihen në impiantin kryesor për trajtimin e ujërave të zeza.<br>Pastrimi i deponive të mbeturinave në brigjet e lumenjeve dhe rrjedhat tjera ujore.<br>Zbatimi i UA për normat e shkarkimeve të ujërave të ndotura nga operatorët ekonomik.<br>Përgatitja e projektit për trajtimin e zonave të mbrojtura sanitare ne Lipjan dhe zonat tjera të përcaktuara në HZK<br>Rritja e kapacitetit për furnizim me ujë të pijes për në vendbanimet që nuk kanë rrjet të ujësjellësit<br>Ndertimi i kolektorëve anësor të ujërave të zeza përgjatë rrjedhave ujore. | Projekti i përgaditur<br><br>Numri i impianteve të instaluara;<br><br>Numri i deponive të pastruara;<br><br>• Numri i rasteve të zbatimit të normave të shkarkimeve të ujërave të ndotura nga operatorët ekonomik;<br><br>Projekti i pergaditur<br><br>Numri i vendbanimeve te perfshira ne rrjetin e ujesjellesit<br>Projektet e implementuara | Mjedis i paster<br>Projekti i finalizuar;<br>• Impinatet e vogla të instaluara;<br>• Deponitë e mbeturinave të pastruara;<br>• Udhëzimi për normat e Shkarkimeve të ujërave të ndotura nga operatorët ekonomik. .<br><br>Ekonomitë familjare të kyçyra në rrjetin e ujësjellësit. |
| | Mbrojtja nga vërshimet dhe përmbytjet | Finalizimi i projektit për rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtratit të lumenjeve<br>Ngritja e vetëdijes së qytetareve për rastet e përmbytjeve. | Projekti i finalizuar;<br><br>Numri i qytetarëve të përfshirë në fushatat e vetëdijësimit dhe numri i materialeve vetëdijesuese të shpërndara; | Shtrati i lumenjve i rregulluar; |
| Ajri dhe zhurma | Plotësimi i bazës rregullative, programore dhe institucionale për menaxhimin e ndotjes së ajrit | Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Cilësi të Ajrit<br>Hartimi i Rregullores për menaxhimin e cilësisë së ajrit<br>Hartimi i Planit Lokal te Mobilitetit | Plani i Veprimit për Cilësi të Ajrit i finalizuar;<br><br>Rregullorja për menaxhimin e cilësisë së ajrit e përgaditur; | Plani lokal i veprimit për Cilësi të Ajrit i miratuar dhe i zbatuar;<br><br>Rregullorja për |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | Plani Lokal i Mobilitetit i finalizuar; | menaxhimin e cilësisë së ajrit e aprovuar dhe e zbatuar;<br><br>Plani Lokal i Mobilitetit i miratuar dhe i zbatuar; |
| | Përmirësimi i cilësisë së ajrit | Identifikimi i burimeve të ndotjes së ajrit përmes hulumtimit të burimeve të emisioneve në ajër.<br>Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra në zonën urbane dhe përrreth zonave komerciale dhe industriale<br>Ndalimi i përdorimit të thëngjillit për ngrohje në zonën urbane<br>Përgaditja e projektit për ndërtimin e infrastrukturës për ngrohje qendrore. | Hulumtimi i burimeve të emisioneve në ajër;<br><br>Sipërfaqja e zonave të gjelbra të reja;<br><br>Vendimi për ndalimin e thëngjillit i miratuar;<br><br>Projekti i përgaditur; | Burimet e ndotjes së ajrit të identifikuara;<br>Zonat e gjelbra të zgjeruara;<br>Cilësia e ajrit e përmirësuar;<br>Projekti i finalizuar; |
| | Përmirësimi i informimit dhe rritja e vetëdijësimit për mbrojtje nga ndotja e ajrit | Sensibilizimi i opinionit lidhur me përfitimet që krijohen me aplikimin e masave efiçiente në objektet e banimit<br>Blerja e stacionit mobil për monitorimin e cilësisë së ajrit në territorin e Komunës së Lipjanit<br>Vendosja e TV ekraneve që tregojnë nivelin e ndotjes në lokacione të ndryshme në qytet<br>Nxitja dhe mbështetja teknike e ekonomive familjare për renovimin e objekteve dhe përmirësimin e izolimit termik. | Numri i qytetarëve të përfshirë në fushatat e vetëdijësimit;<br>Numri i materialeve vetëdijesuese të publikuara;<br>Stacioni mobil për monitorimin e ajrit i blerë;<br>Numri i TV ekraneve që tregojnë nivelin e ndotjes së ajrit.<br><br>Numri i ekonomive familjare që kanë përimirësuar izolomin termik. | Vetëdija për efiçiencën në objektet e banimit e ngritur;<br>Cilësia e ajrit në territorin e komunës e monitoruar;<br>Informimi i qytetarëve për cilësinë e ajrit i përmirësuar.<br>Izolimi termik në objektet e ekonomive familjare i përmirësuar dhe zvogëlimi i konsumit të energjisë. |
| | Reduktimi i zhurmës | Hartimi i Planit Lokal për Reduktimin e Zhurmës<br>Vendosja e barrierave për reduktimin e zhurmrës përreth objekteve që shkaktojne zhurmë /autoudha, zonat komerciale/ indsutriale.<br>Reduktimi i qarkullimit të auromjeteve të rënda në zonën urbane (Caktimi i rrugëve për kalimin e mjeteve transportuese mbi pesha 7.5t)<br>Zbatimi i orarit për limitetet e tejkalimit të normave të zhurmës në zonat urbane /HZK | Plani Lokal për Reduktimin e Zhurmës i përgaditur;<br><br>Gjatësia e barierave të vendosura për reduktimin e zhurmrës;<br><br>Numri i automjeteve të rënda që qarkullojnë në zonën urbane;<br>Numri i anakesave për tejkalimin e normave të zhurmës në zonat urbane | Plani Lokal për Reduktimin e Zhurmës i aprovuar dhe i zbatuar;<br><br>Zhurmra e reduktuar;<br>Qarkullimi e automjeteve të rënda në zonën urbane i reduktuar;<br><br>Zbatimi i normave për |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | limitetet e zhurmës në zonat urbane. |
| Shfrytezimi i tokes dhe cilesia e dheut | Mbrojtja e tokës bujqësore me cilësi të lartë nga ndërtimi | Fushatë vetëdijësimi dhe informimi për mbrojtjen e tokës bujqësore<br>Mbikëqyrje e ndërtimeve në tokën bujqësore sipas kritereve të HZK.<br>Hartimi i Planit të zhvillimit rural | Numri i takimeve me farmer dhe numri i materialeve për vetëdijesim dhe informimi për mbrojtjen e tokës bujqësore;<br><br>Numri i ndërtimeve në tokën bujqësore;<br>Nurmri i rasteve të parcializimit të tokave bujqësore;<br>Plani i zhvillimit rural i pergaditur. | Ngritja e vetëdijesimit dhe informimit për mbrojtjen e tokës bujqësore; Ndërtimet në tokën bujqësore të reduktura; Parcializimi i tokave bujqësore i reduktuar; Zhvillim i planifikuar i bujqësisë. |
| | Mbrojtja e tokës nga erozioni dhe përmrësimi i tokave të degraduara | Identifikimi i tokave të ndikuara nga erozioni<br>Pyllëzimi i sipërfaqeve të tokës të ndikuara nga erozioni<br>Aplikimi i subvencioneve dhe stimulimeve për farmerët që punojnë tokat djerrina. | Sipërfaqet e tokave të ndikuara nga erozioni;<br>• Sipërfaqet e tokave të pyllëzuara;<br>• Numri i rasteve të fermerëve të suvencionuara dhe të stimuluar nga komuna;<br>• Sipërfaqet e tokave të punuara | Tokat e ndikuara nga erozioni të identifkuara; Sipërfaqet e tokës të ndikuara nga erozioni të pyllëzuara; Subvencionet dhe stimulimet për farmerët që punojnë tokat djerrina të realizuara; Siperfaqja e tokave bujqësore te punuara. |
| | Ulja e kontaminimit të tokës nga burimet direkte dhe jo - direkte | Pastrimi i tokave bujqësore nga deponitë e mbeturinave komunale<br>Pastrimi i tokave bujqësore nga deponitë e mbetjeve të makinave<br>Ndalimi i derdhjes së ujërave urbane në toka bujqësore<br>Fushata vetëdijësimi me farmerë/e për përdorimin e drejtë të plehrave kimike dhe përmirësimin e cilësisë së tokës | Numri i deponive të mbeturinave të pastruara në tokat bujqësore;<br>• Numri i rasteve të ndalimit të derdhjes së ujërave urbane në toka bujqësore;<br>• Numri i fermerëve të përfshirë në fushata të vetëdijësimit. | Tokat bujqësore të pastruara nga deponitë e mbeturinave komunale dhe mbetjeve të makinave<br>• Tokat bujqësore të pastruara nga derdhja e ujërave urbane;<br>• Farmerët e vetëdijësur për përdorimin e drejtë të plehrave kimike. |
| Menaxhim i | Përmirësimi i sistemit për grumbulimin e | Rritja e numrit te ekonomive familjare në sistemin e grumbullimit te mbeturinave<br>Shtimi i kapaciteteve teknike të NP "Pastrimi" për grumbullimin e | Numri i ekonomive te reja familjare në sistemin e grumbullimit te mbeturuinave;<br>• Numri i kontenjerëve | Deponive ilegale të mbeturinave të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | mbeturinave | mbeturinave<br>Pastrimi i deponive ilegale të mbeturinave komunale dhe deponive të mbeturinave nga makinat e vjetra<br>Aplikimi i gjobave për personat fizik dhe juridik qe hedhin mbeturinave në vendet jo adekuate | të riinjë dhe i kamionëve të NP Pastrimi për grumbullimin e mbeturinave; Numri i deponive ilegale të mbeturinave të pastruara; • Numri i gjobave për persoat fizik dhe juridik që hedhin mbeturinave në vendet jo adekuate. | pastruara;<br><br>Zbatimi i UA për gjobat manadatore për mbeturina. |
| Natyra dhe biodiversiteti | Rritja e nivelit dhe mundesive per reciklimin dhe kompostimin e mbeturinave | Shtimi i kapaciteteve teknike për ndarjen e mbeturinave në vendburim<br>Fushatë vetëdijësimi për reciklimin e mbeturinave komunale;<br>Shpërndarja e komposterëve familjarë për komopostimin e mbeturinave organike. | Numri i shpërndarë i kontenjerëve për ndarjen e mbeturinave në vendburim; • Numri i qytetarëve të përfshirë në fushatat e vetëdijësimit. • Numri i shpërndarë i komposterëve familjarë për komopostimin e mbeturinave organike | Shtimi i kapaciteteve teknike për reciklimin e mbeturinave në vendburim; Ngritja e vetëdijes së qytetarëve për reciklimin e mbeturinave komunale. Sasia e mbeturinave organike që dërgohen në deponi e zvogëluar. |
| | Rritja e numrit t ë zonave të mbrojtura dhe promovimi i vlerave të tyre natyrore | Hartimi i planit lokal të veprimit për biodiversitetin<br>Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës<br>Shenjëzimi i zonave të mbrojtura të natyrës<br>Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit | Hartimi i Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin; • Marrja në mbrojtje e zonave të reja të natyrës; • Shenjëzimi i zonave të mbrojtura të natyrës; • Fushatë vetëdijësimi për mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit; | Miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin; Vlerat e natyrës të mbrojtura; Zonat e mbrojtura të natyrës të shenjuara; Ngritja e vetëdijes për mbrojtjen e natyrës dhe promovimin e ekoturizmit. |
| | Parandalimi i veprimeve që e dëmtojnë natyrën, biodiversitetin dhe pyjet | Implementimi i masave për parandalimin e zjarreve në male. | Numri i masave për parandalimin e zjarreve; Numri i aksioneve për ndalimin e gjuetisë ilegale; • Numri i aktiviteteve për parandalimin e degradimit dhe prerjeve ilegale të pyjeve. | Numri i rasteve të zjarreve në pyje i zvogëluar; Gjuetia ilegale e faunës së egër e zvogëluar; • Pyjet e mbrojtura nga degradimi dhe prerjet ilegale. |
| | Parandalimi i efekteve mjedisore nga | Zbatimi efikas i VNM n ë projektet e nivelit lokal<br>Integrimi i VSM -së në kuadër të | Numri i raporteve të VNM -së në projektet e nivelit lokal; | VNM në projektet e nivelint lokale |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | zhvillimet e reja | planeve, programeve në nivelin lokal | • Numri i raporteve të VSM -së për planet dhe programeve në nivelin lokal. | zbatuar;<br>• Zbatimi i VSM -së në kuadër të planeve dhe programeve në nivelin lokal. |
| | Ngritja e vetëdijes mjedisore dhe nxitja e pjesëmarrjes shoqërore në vendimmarrjen mjedisore | Organizimi i fushatave vetëdijesuese për mbrojtjen e mjedisit në shkollat fillore<br>Bashkëpunimi me OJQ dhe Shoqërin Civile për procesin e vendimmarrjes mjedisore<br>Nxitja e Partneritetit Publiko Privat (PPP) ose Pjesëmarrjen e Sektorit Privat (PSP) në menaxhimin e mbeturinave. | Numri i nxënësve dhe shhkollave të përfshira në fushatat vetedijesuese;<br>• Numri i OJQ dhe pjesëtarëve të Shoqërisë Civile të përfshirë në procesin e vendimmarrjes mjedisore;<br><br>Marreveshjet e arritura | Vetëdija e nxënsve të shkollave fillore për mbrojtjen e mjedisit e ngritur; Ngritja e bashkëpunimit me OJQ dhe Shoqërinë Civile për procesin e vendimmarrjes mjedisore;<br>Ngritje e nivelit të bashkëpunimit. |
| | Fuqizimi i inspektoratit mjedisor | Shtimi i numrit të inspektorëve për sektorin e mjedisit dhe mbeturinave<br>Përmirësimi i kushteve të punës për inspektorët dhe zbatimi i stimulimeve<br><br>Zyrtari për mjedis – Sektori i Mjedisit. | Numri i inspektoreve për sektorin e mjedisit dhe mbeturinave;<br>• Numri i pajisjeve dhe mjeteve të punës si dhe format e stimulimeve.<br><br>Plotesimi i stafit ne fushen e mjedisit | Rritja e numrit të inspektorëve për sektorin e mjedisit dhe mbeturinave.<br><br>Kushtet e punës për inspektorët të përmirësuara dhe simulimet e zbatura. |